R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
BASHKIA PËRMET

MIRATOHET

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Z.ANILA MIHALI

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr.50,Datë 01/08/2022

STRATEGJIA PËR ZVOGËLIMIN E RISKUT TË FATKEQËSIVE NË BASHKINË PËRMET

GUSHT 2022

Dokumenti i vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë përshkuan progresin e deritanishëm të punës dhe kontekstin në detyrimet që rrjedhin në nivelin lokal, bazuar në Ligjin Nr.45/2019 ''Për Mbrojtjen Civile'', si dhe detyrimet që rrjedhin nga Kuadri Sendai për Reduktimin e Riskut të Fatkeqësive, Marrëveshjes së Parisit për Ndryshimet Klimatike.

Ky dokument u përgatit nga Grupi i punës të ngritur në bashkinë Përmet, nën drejtimin e Kryetarit të Bashkisë zj.Alma Hoxha.

Grupi i punës:

Florand Hasani
Bekim Meçani
Laert Bushi
Arjan Jaupi
Bujar Ibrahimi
Thanas Nikolla
Fredi Lipe

PËRMBAJTJA

HYRJE..... 5

1. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E PLANIT TË ZVOGËLIMIT TË RISKUT TË FATKEQËSIVE.....7

2. KUADRI INSTITUCIONAL.....8

3. VLERËSIM I RISQEVE NË BASHKINË PËRMET.....11

- *3.1 Hyrje*
- *3.2 Pozicioni gjeografik*
- *3.3 Relievi*
- *3.4 Klima*
- *3.5 Rreshjet atmosferike*
- *3.6 Hidrografia*
- *3.7 Përbërja e tokës*
- *3.8 Përbërja e shkëmbenjve*
- *3.9 Bota bimore dhe shtazore*

***4.* EKONOMIA E PËRMETIT.....13**

- *4.1 Bujqësia*
- *4.2 Sistemi energjitik*
- *4.3 Infrastruktura rrugore*
- *4.4 Telekomunikacioni*
- *4.5 Shëndetësi*
- *4.6 Arsimi*

***5.* DEMOGRAFIA.....19**

***6.* VLERËSIMI I RREZIQEVE.....19**

***7.* RREZIQET DHE RISKU I FATKEQËSIVE NATYRORE.....21**

***8.* REDUKTIMI I RISKUT NGA FATKEQËSITË PËRMES POLITIKAVE DHE INSTRUMENTAVE SEKTORIALË.....42**

***9.* MASAT DHE VEPRIMET PËR JETËSIMIN E STRATEGJISË…….……43**

- **9.1 Informimi, ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve komunitare për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive**
  - *9.1.1 Ngritja e Grupit të Vullnetarëve*
  - *9.1.2 Trajnimi i Grupeve Vullnetare*
  - *9.1.3 Trajnimi i Komunitetit*
  - *9.1.4 Fushata Informimi Komuniteti*
  - *9.1.5 Fushata Ndërgjegjësimi për Pastrimin e Kanaleve Tretësore nga Fermerët*
  - *9.1.6 Fushata Ndërgjegjësimi për Rrezikun ndaj Zjarrit në Pyje*
  - *9.1.7 Menaxhimi i Ekonomive Pyjore Nëpërmjet Komunitetit*
- ***9.2 Ngritja e kapaciteteve institucionale, qeverisëse për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive***

- *9.2.1 Trajnim i Vazhduar Stafi i Bashkisë për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive*
- *9.2.2 Trajnim i Vazhduar i Komitetit të Mbrojtjes Civile*
- *9.2.3 Rishikimi i PPV me Fokus Përshtatjen për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive*
- *9.2.4 Rishikimi/ Hartimi i Strategjive dhe Planeve Sektoriale me Fokus Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive*
- *9.2.5 Ngritja dhe Mirëmbajtja e Databazës së Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive në Bashkinë Përmet*

➢ ***9.3 Zvogëlimi i riskut të fatkeqësive***
- *9.3.1 Pastrimi i Kanaleve Dytësore*
- *9.3.2 Studim për Rehabilitimin dhe Ndërtimi i Pritave Malore*
- *9.3.3 Rehabilitimi dhe Ndërtimi i Pritave Malore*
- *9.3.4 Studim mbi Gjendjen e Digave*
- *9.3.5 Përmirësimi i Gjendjes së Digave sipas Studimit*
- *9.3.6 Studim Sizmik për Ndërtesat me Moshë mbi 30 Vjet*
- *9.3.7 Studim Sizmik për Ndërtesat me Rëndësi të Veçantë*
- *9.3.8 Studim Sizmik për Ndërtesat Informale*
- *9.3.9 Marrja e Masave për Përmirësimin e Kushteve të Ndërtesave*
- *9.3.10 Studim dhe Monitorim i Zonave me Rrezik Rrëshqitje*
- *9.3.11 Studim mbi Largimin e Shkëmbinjve/Gurrëve me Rrezik*
- *9.3.12 Marrja e Masave për Largimin e Shkëmbinjve/ Gurrëve*
- *9.3.13 Pyllëzimi i Zonave Pyjore të Djegura*
- *9.3.14 Studim Inxhinierik për Gjendjen e Infrastrukturave Kritike (ura dhe pacarela)*
- *9.3.15 Marrja e Masave Inxhinierike për Përmirësimin e Gjendjes së Infrastrukturave Kritike (ura dhe pacarelave)*

➢ ***9.4 Ngritja e kapaciteteve institucionale, operacionale dhe përgatitja për përballjen e situatave emergjente***
- *9.4.1 Hartimi, Monitorimi dhe Përditësimi i Planit të Emergjencave Civile*
- *9.4.2 Hartimi i Planeve të Evakuimit në Ndërtesa të Rëndësisë së Veçantë dhe Vendosja e Sinjalistikës së Nevojshme*
- *9.4.3 Plotësimi i Nevojave me Pajisje për Rastet e Emergjencave*
- *9.4.4 Ngritja e Sistemeve të Paralajmërimit të Hershëm*

10. VLERËSIME PËRFUNDIMTARE.....46

11. REFERENCA LIGJORE…….47

12. DOKUMENTE STRATEGJIKE……47

HYRJE

Aftësia ripërtëritëse tashmë është kthyer në një koncept drejtues për politikëbërjen e lidhur me zhvillimin hapësinor dhe veçanërisht përsa i përket riskut të fatkeqësive.

Koncepti i aftësisë ripërtëritëse ka evoluar në kohë dhe ka përkufizime të ndryshme, por një gjë e cila është konvergjente në të gjitha rastet është aftësia e një vendi, autoriteteve dhe sistemeve socio-ekologjike për t'u rimëkëmbur pas një krize. Në këtë sens, koncepti është gjithëpërfshirës dhe shumëdimensional duke përfshirë jo vetëm rimëkëmbjen fizike në territori por edhe faktorë të shumtë socialë dhe ekologjikë. Aftësia ripërtëritëse dhe zvogëlimi i riskut të fatkeqësive kanë marrë një vemendje të rëndësishme në nivel global. Kjo gjë vërehet në prioritetet e Kuadrit Sendai, në Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, ashtu edhe në Anxhendën e Re Urbane (UN Habitat, 2016) dhe Axhendën Urbane të Bashkimit Evropian (Informal Meeting of EU Ministers Responsible for Urban Matter, 2016). Të gjitha këto dokumente strategjike globale vendosin një theks të rëndësishëm dhe tek autoritetet vendore duke qënë se impakti më i madh i krizave është gjithmonë në nivel lokal.

Kuadri Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2015-2030 u miratua në Konferencën e tretë Botërore të KB në Sendai, Japoni, më 18 Mars 2015. Kuadri Sendai artikulon nevojën për të kuptuar më mirë riskun e fatkeqësive në të gjitha dimensionet si ekspozimi, ndjeshmëria dhe karakteristikat e rrezikut. Gjithashtu advokon për forcimin e qeverisjes duke përfshirë platformat kombëtare si dhe rritjen e përgjegjësisë për menaxhimin e gatishmërinë për të «Ndërtuar më mirë» pas një fatkeqësie. Njohja e palëve të interesit dhe rolet e tyre është një fatktor I rëndësishëm për menaxhimin dhe zvogëlimin e riskut. Kuadri Sendai i kërkon autoriteteve mobilizimin e investimeve të ndjeshme ndaj riskut për të shmangur krijimin e risqeve të reja si dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së infrastrukturës shëndetësore, trashëgimisë kulturore dhe vendeve të punës. Gjithashtu, kërkon forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe partneritetit global, politikave dhe programeve të donatorëve të informuar për risqet duke përfshirë edhe mbështetjen financiare dhe huatë nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Kuadri Sendai gjithashtu, propozon 4 prioritete përsa i përket **Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive**:
Prioriteti 1: Kuptimi i riskut të fatkeqësisë
Prioriteti 2: Forcimi i qeverisjes së riskut të fatkeqësive për të menaxhuar riskun
Prioriteti 3: Investimi në zvogëlimin e riskut të fatkeqësive për të rritur aftësinë ripërtëritëse dhe qëndrueshmërinë
Prioriteti 4: Rritja e gatishmërisë ndaj fatkeqësive për reagim efektiv dhe për "Ndërtimi më mirë"

Një tjetër parim shumë i rëndësishëm përsa i përket strategjive të **Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive** në nivel lokal është integrimi i politikave dhe kulturës së **Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive** në të gjithë sektorët, e veçanërisht në sektorin e planifikimit të territorit. Integrimi i strategjive të **Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive** në planet e zhvillimit të territorit vjen me sfida të veçanta, por gjithashtu gjeneron mundësi për zhvillim të qëndrueshëm, duke sjellë potencialisht përfitime ekonomike. Ndikimet e fatkeqësive ndjehen menjëherë dhe intensivisht në nivelin lokal. Fatkeqësitë shpesh ndodhin, dhe risku shpesh shfaqet, në nivel lokal, kështu që shumë nga mjetet më efektive për të zvogëluar ekspozimin dhe cenueshmërinë ekzekutohen në këtë nivel. Këto instrumenta përfshijnë rregulloret e përdorimit dhe zhvillimit të tokës, zbatimin e standarteve të ndërtimit, si dhe menaxhimin mjedisor që janë thelbësore për **Zvogëlim të Riskut të Fatkeqësive** efektive. Qeveritë dhe komunitetet duhet të angazhohen dhe të punojnë së bashku në nivelin vendor për **Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive**.

Zvogëlimi i riskut të fatkeqësive dhe zhvillimi i aftësisë ripërtëritëse duhet të krijojnë një trashëgimi të udhëheqjes ku shfaqet besimi i rritur dhe legjitimiteti i strukturave të autoritetit vendor. Këto duhet të bazohen në kompetenca të decentralizuara dhe optimizimin e burimeve. Zvogëlimi i humbjeve nga fatkeqësitë duke mbështetur në të njëjtën kohë rritjen ekonomike dhe zhvillimin social-kulturor mund të ofrojë siguri edhe për investitorët. Zhvillimi i komuniteteve të jetueshme, me ekosisteme të ekuilibruara, planifikim dhe dizajn më të mirë urban, dhe pjesëmarrje aktive të qytetarëve krijojnë një platformë të suksesshme për qeverisjen territoriale.

1: QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E PLANIT TË ZVOGËLIMIT TË RISKUT TË FATKEQËSIVE.

Shqipëria renditet në mënyrë të vazhdueshme në vendin e parë në Evropë,sipas raportit vjetor të Riskut Botëror i Universitetit të Kombeve të Bashkuara,e cila llogarit indeksin e Riskut të Fatkeqësive Natyrore për 180 vende bazuar në ekspozimin,ndjeshmërinë,cënueshmërinë dhe aftësinë përballuese e përshtatëse për periudhën 2011-2019.

Veçoritë e riskut të fatkeqësive,si;rreziku,ekspozimi,cënueshmëria dhe kapacitetet përballuese ndaj tyre janë më së shumti lokale.Gjatë këtyre viteve ,përvoja e menaxhimit të fatkeqësive ka vënë në dukje mangësi thelbësore .Më së shumti I është dhënë rëndësi kapaciteteve reaguese dhe jo krijimit të një kulture sigure dhe aftësie ripërtëritëse personale e komunitare mbi rreziqet natyrore dhe rreziqet e tjera.

Në rast fatkeqësie natyrore dhe fatkeqësi të tjera bashkia është porta ku qytetarët do të kërkojnë ndihmë lidhur me shqetësimet e tyre për rrezikun dhe cënueshmërinë,pasi këto të fundit është përgjegjëse për sigurinë e komuniteteve.

Bashkia Përmet përballet me një shumëllojshmëri rreziqesh e për pasojë edhe risqesh të fatkeqësive natyrore. Përmeti është i rrezikuar nga zjarret në pyje e kullota,nga bllokimi i rrugëve nga dëbora,ndryshimi i regjimit të reshjeve ,ndryshimet klimatike të manifesuara me rritje temeraturerrit propabilitetin e shtimit të fatkeqësive në të ardhmen të përmbytjeve. Tërmetet e vitit 2019 edhe pse nuk solli humbje të jetëve njerëzore dhe dëme material në objekte banimi,risjell në vëmendje një risk të përhershëm.Risqet e tjera që vijnë nga zjarret në pyje e kullota,bllokimi nga dëbora,gëryerja e tokës,rënia e gurëve dhe shkëmbenjve,përmbytjet pavarësisht nga dëmi janë prezent në territorin e bashkisë Përmet.

Duke parë shumëllojshmërinë e risqeve me të cilat përballet bashkia Përmet ky dokument do shërbejë si bazament së bashku me Planin Vendor për Emergjencat Civile,në zbatim të kërkesave ligjore në Mbrojtjen Civile.


Nga pikëpamja metodologjike ky dokument aplikon një qasje gjithëpërfshirëse dhe të integruar Planifikimi me pjesëmarrje; a)mundëson evidentimin e problematikave specifike në territor, b)si qëllim trajnimin e komunitetit dhe institicioneve të tjera.

Ky dokument ka në qëndër të vëmendjes bashkëpunimin institucional dhe pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme komunitare me qëllim institucionalizimin e kulturës së reduktimit të riskut të fatkeqësive dhe ngritjen e kapaciteteve vendore në këtë fushë.

Instrumentat e përdorur nga ana metodologjike: a)Vizita dhe vëzhgime të drejtpërdrejta në terren; b)Intervista me qytetarë,specialist ,biznese; c)Hartëzim me pjesëmarrje të riskut; ç)Fokus grupe

tematikë(varësisht llojit të rrezikut,riskut dhe sektorit); d)Hartëzim me pjesëmarrje i kalendarëve sezonalë dhe historik të riskut; e)Vlerësimi i riskut në platformën GIS (nuk kemi).

Figura1.Përmbledhje e instrumentave metodologjikë dhe hapave përkatës.



2:KUADRI INSTITUCIONAL

Një ndër parimet e ligjit Nr 139/2015'' *Për Vetëqeverisjen Vendore*''është ai i "*Subsidiaritetit*'',i cili është '*'parimi i kryerjes së funksioneve dhe ushtrimit të kopetencave në një nivel qeverisje sa më pranë komunitetit,duke patur parasysh rëndësinë dhe natyrën e detyrës,si dhe kërkesat e efiçensës e të ekonomisë''.* Në këtë kontekst bazuar në nenin 29 të këtij ligji,bashkia ,si autoritet vendor ka kopetencë të drejtpërdrejtë në fushën e mbrojtjes civile. Në vitin 2019 është miratuar ligji Nr.45/2019''*Për Mbrojtjen Civile*,,si ligj sektorial i cila ka për qëllim zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe realizimin e mbrojtjes civile,për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve,pronës,gjësë së gjallë,trashëgimsë kulturore dhe mjedisit,nëpërmjet forcimit të sistemit

të mbrojtjes civile.

Misioni i mbrojtjes civile është krijimi i kushteve për një shoqëri të aftë për të përballuar fatkeqësitë e ndryshme dhe për t'u rimëkëmbur nëpërmjet ngritjes së një sistemi të integruar dhe efikas të mbrojtjes civile në Republikën e Shqipërisë.

Instrumentat e Ligjit Nr 45/2019''Për Mbrojtjen Civile''


1. Dokumenti i Vlerësimit të riskut dhe cënueshmërisë në nivel vendor.
2. Strategjia vendore për zvogëlimin e riskut.
3. Plani i emergjencave civile në nivel vendor.

Në nivel kombëtar është themeluar Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile,si person juridik publik qëndror në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes.Ky është organi kryesor në nivel kombëtar përsa i përket ushtrimit të detyrave të mbrojtjes civile.
Prefekti i qarkut ka rolin parësor në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.Duke ju referuar ligjit nr 45/2019 ai ka për detyrë koordinimin e veprimeve të organeve,institucioneve dhe strukturave që veprojnë në nivel qarku si dhe grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave të nevojshme nga bashkitë dhe strukturat e tjera.Gjithashtu prefekti siguron koordinimin e shpërndarjen e asistencës ndërkombëtare në rastet e fatkeqësive,si dhe kontrollon zbatimin e masave të marra nga bashkia.
Në nivel vendor ,sipas ligjit nr 45/2019 bashkia ka disa detyra të cilat përfshijnë: informimin e publikut dhe komunitetit të rrezikuar dhe organizimin e veprimtarive trajnuese në fushën e mbrojtjes civile për punonjësit dhe banorët në territorin e tyre.Gjithashtu bashkitë sigurojnë,administrojnë dhe përditësojnë të dhënat e nevojshme për shtetasit dhe subjektet private,të mundshmme për t'u planifikuar dhe angazhuar në parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive,kryejnë investime parandaluese,mbrojtëse dhe rehabilituese nga fatkeqëësitë si dhe caktojnë drejtuesin operacional në nivel bashkie.


Figura 2.Struktura institucionale për mbrojtjen civile në Shqipëri

KOMISIONI I EMERGJENCAVE CIVILE


Nivel Kombëtar



Nivel Rajonal



Niveli lokal



Në bashkinë Përmet është ngritur Sektorit i emergjencave civile, mbrojtjes se qytetarit dhe mjedisit. Ndërsa me urdhër të kryetarit të bashkisë është ngritur dhe funksionon komisioni i mbrojtjes civile në nivel bashkie,në të cilën janë përfshirë jo vetëm struktura të bashkisë por dhe përfaqësues të institucioneve të tjera në rreth,si dhe përfaqësues të shoqërisë civile,të fesë,etj.

3: VLERËSIM I RISQEVE NË BASHKINË PËRMET


3.1 Hyrje

Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga dukuritë natyrore apo fatkeqësi të tjera,faktori njeri mund të rrezikojnë jetën e njerëzve,gjësë së gjallë,pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.Të gjitha këto dukuri,fenomene si ato natyrore dhe ato nga dora e njeriut manifestohen me rreziqe dhe paraqesin sfida me të cilat ballafaqohet individi,komuniteti pasuria,rrjeti i shërbimeve.Në këtë kuadër rëndësi marrin masat parandaluese,mbrojtëse dhe rehabilituese.Bashkia Përmet është i ekspozuar nga rreziqet në shkallë të përmasave të ndryshme,të cilat paraqesin kërcënim për sigurinë publike.

Bashkia Përmet është njësi e vetëqeverisjes vendore dhe përfaqëson një unitet administrative-territorial dhe bashkësi banorësh.Bashkia përbëhet nga 5 njësi administrative: Përmet,Qëndër Piskovë,Petran,Çarçovë dhe Frashër.

Nga pikëpamja e vendbanimeve,në bashki ndodhet një zonë urbane (qyteti i Përmet dhe 45 fshatra me një popullsi rreth 19272 banorë dhe sipas censusit 10614 banorë.

Figura .3 (foto te relievit te bashkise Përmet)



3.2 Pozicioni gjeografik

Bashkia e Përmetit bën pjesë në Qarkun e Gjirokastrës dhe shtrihet në pjesën juglindore të Shqipërisë.

Kufijtë gjeografikë : Nga Veriu kufizohet me bashkinë Skrapar , në lindje me bashkinë kolonjë , në Jug me Konicën (shteti Grek) dhe bashkinë Dropull, perëndim me bashkiinë Libohovë dhe bashkinë Këlcyrë .

3.3 Relievi

Bënë pjesë në zonat malore dhe kodrinore me reliev tepër të thyer dhe të shumëllojshëm. Territori i rrethit ka shtrirje të madhe në drejtim vertikal, nga 160 metra deri 2485 metra (maja e Papingut në Nëmërckë). 6.3% e territorit shtrihet deri në lartësinë 300 m, 65.3 % mbi lartësinë 300m dhe 28.4% mbi 900 m mbi nivelin e detit.

Ne pergjithesi ka karakter kodrinor e malor.Dallohen qarte tre njesi fizko – gjeografike , ajo e vargmaleve Dangelli – Postenan , Lugina e siperme e Vjoses dhe vargu Dhembel – Nemercke.Dangellia shtrihet nga rrjedhae lumit Lemnice deri ne rrjedhjen e lumit Langarice. Eshte zone malore , ka male qe kalojne lartesine1500m .Dallohen mali i Qelqezes 1662 m , mali i Micanit 1557 m , mali i Kokojkes 1550 m, mali Taborit 1495 m etj.

Postenani shtrihet ne te majte te rrjedhjes se lumit Langarice. Ketu bene pjese mali i Postenanit 1560 m dhe mali Carshoves 1100 m.

3.4 Klima

Permeti eshte kryesisht vend kodrinor – malor. Klima ne pergjithesi paraqitete ngrohte. Rol te rendesishem luajne drejtimi i maleve veriperendim - juglindje , te cilat behen pengese per ardhjen e ererave te ngrohta detare ne gjithe luginen ,prandaj lugina ka klime mesdhetare-kodrinore. Ne klime luajne rol edhe mikroklimat . Keshtu marejasi bime mesdhetare zhvillohet ne krahun e djathte te lumit Vjosa,sepse eshte perkundrejt diellit. Edhe bora kur bie shkrine me shpejt ne kete krah te lugines. Nje mikro klime shume interesante ndodhet ne veri te fshatit Mican ne vendin e quajtur Dervishje . Aty rritet bima e ullirit nen ndikimin e ererave mesdhetare qe depozitojne nepermjet lugines se lumit Osum . Ne drejtim te lartesise klima behet me ftohte. Ne vargun Trebeshine – Dhembel – Nemercke dhe malesine e Dangellise klima behet me e ashper.

3.5 Rreshjet atmosferike

Mesatarja shume vjecaree rreshjeve ne permet eshte 1315 mm. Pjesa me e madhe e tyre bie gjate dimrit, ndersa ne stinene veres jane te paketa. Rreshjet kane karakter te vrullshem dhe te pernjehershem. Ne lugine rreshjet janene formen e shiut ndersa debora eshte nje fenomen i rralle. Vetem ne zonen e Frasherit, m. Postenan, m.Dhembelit, m. Nemerckes rreshjet jane ne formen e debores,trashesia e se ciles arrinderi ne 30-50 cm. Bresheri eshte nje fenomen i rralle dhe bie sidomos ne stinen e pranveres**.**

3.6 Hidrografia

Territori i Bashkisë ka burime të shumta ujore rrjedhese (lumenj, perrenj) Karakteri malor ka bereqe ata te jene te vrullshemdhe me veprimtari te madhe gerryese te cilat duke kaluar ne formacione shkembore kane krijuarnje sere grykashte ngushta e te thellate quajtura kanione.

Ai përshkrohet nga **Lumi Vjosa**, i cili është lumi i dytë në Shqipëri për nga gjatësia (272 km) dhe rezervat hidrike që përmban.Perfaqeson ujerat rrjedhesete teritorit te bashkise. Pasi pershkon nje pjese te tokes Greke

hyn ne teritorin tone ne afersi te Tri Urave ku merr me vete dhe degen tjeter, lumin Sarandapor Vjosa ka drejtim Juglindje- Perendim. Prurjet mesatare vjetore arrijnë 195 m²/sek. Vjosa krijon edhe luginën e saj, që dallohet për bukurinë e saj. Ky lum përbën edhe aksin kryesor të organizimit dhe komunikimit të komuniteteve lokale në rrethin e Përmetit të cilat kanë një identitet të fortë territorial, për shkak të vendodhjes në luginën e Vjosës, që kalon kufijtë e bashkisë së sotme të Përmetit. Lugina e Vjosës karakterizohet nga një biodiversitet i pasur, njëshumëllojshmëri speciesh ndër të cilat edhe specie në zhdukje që duhen mbrojtur.

Lumi I Langarices me gjatesi 36 km e ka burimin ne malin e Gramozit. Ai derdhet ne lumin Vjosane afersi te fshatit Petran. Rruga qe pershkon eshte me pjerresi te madhe dhe fuqi gerryese neper zona shkembore-gelqeroreduke krijuar nje kanion madheshtorqe njihet me emrin " Kanioni Langarices**"**

Lumi I Lemnices bashkohet me lumin Vjosa ne afersi te fshatit Piskove dhe ushqehet me ujrat qe rrjedhin nga Qarrishta dhe malesia e dangellise ku ka krijuar kanionin e " Kamenckes ". Ka nje gjatesi 17.7 km.

Lumi I Carshoves bashkohet me lumin Vjosa ne fshatin Carshove dhe ushqehet me ujerat qe rrjedhin nga mallet postenan , Melesin dhe perrenjtee Leskovikut.

Burimet e ujit te pishem kryesisht dalin gjete rrjedhjes se Vjoses si ne Dracove, Strembec, Kaludh Leshice, Permet etj. Burime te shumta ka dhe ne zonat malore .

Ujrat termale Pranë fshatit Bënjë (14 km larg qytetit të Përmetit), në njësinë administrative Petran, burojnë ujërat termale të njohura me emrin Banjat e Bënjës. Këto ujëra kanë veti kurative për një sërë sëmundjesh dhe përbëjnë një nga pasuritë më njohura të burimeve nëntokësore të zonës. Gjashtë burime në rrëzë të shkëmbinjve masivë, në të dy anët e lumit Lengaricë, dalin në sipërfaqe dhe krijojnë "vaska" natyrore të ujit termal, të cilat vizitohen nga vizitorë të shumtë vendas. Këto ujrat me bazë sulfurore kanë efekte shumë të larta kuruese. Katër nga burimet përdoren për sëmundje kronike të reumatizmës, një tjetër për sëmundjet e stomakut, dhe i fundit për sëmundjen e lëkurës. Ujrat termale të Bënjës kanë një temperature 26 – 32 grade.

Rezervuarët

Ngritja e digave te rezervuareve dhe ndertimi i tyre ka nisur 50 vjet me pare te cilat u ndertuan per qellime bujqesore. Sot ne bashkine Permet ka … rezervuar. Te gjitha digat jane te ndertuara me mbushje dheu . Lartesia e digave arrin nga 10 – 60 m . Rezervuaret ne radhe te pare jane ndertuar per nevoja te bujqesise dhe te ujitjes .

3.7 Përbërja e tokës

Përmeti ka si tipar paqëndrueshmërinë masive të tokës,I cili shkakton veprim mekanik I ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësor,rreshje,veprim sizmik,shpyllëzim pa kriter.Paqëndrueshmëria e tokës në bashkine e Përmets vjen kryesisht pas shirave të rëmbyeshëm,e cila dëmton rrjetin rrugor dhe tokat bujqësore.Këta përrenj,sjellin vëllime aluvionesh dhe shkaktojnë dëme të paparashikueshme në infrastrukturë,objekte banimi dhe gëryerje toke e cila shkon deri në 0.2% çdo vit.

3.8 Përbërja e shkëmbenjve

Nga studimet e kryera e terrenit në rrethin e Përmets janë veçuar lloje shkëmbinjsh dhe dherash si fonacion shkëmbor rrënjor dhe formime të dherave mbulesorë të Kuaternarit.Këto depozitime janë të përbëra nga argjira,alevrite,rëra,zhavore.Trashësia e mbulesës është 0.5 me maskon shkëmbonjtë rrënjësor.Masa kryesore është argjirë dhe në brendësi të tyre takohen cipa blloqesh shkëmbinjsh të ndryshëm.Të cilat në një situatë shirash,tërmetesh paraqesin rrezik për sigurinë rrugore,por dhe të banorëve,terrene të paqëndrueshme.

3.9 Bota bimore dhe shtazore

Pyjet në Bashkine Permet kanë qenë dhe jane një pasuri mjaft e madhe, vec te tjerash, ato kanë ndikuar pozitivisht në cilësinë e jetës së banorëve të qytetit Permet dhe fshatrave përreth. Pas viteve "90-të u vu re

dukshëm një përkeqësim i madh i situatës së mbulesës bimore, si rezultat i prerjes pa kriter të pyjeve, por edhe si rezultat i djegies së tyre. Edhe pse me kalimin e kohës janë marrë mjaft masa për mbrojtjen e pyjeve, po punohet qe situata te jete tërësisht në kontroll.
Bashkia ka ne administrim nje fond pyjor/ kullosor prej11 585.38 ha.Pjesa me e madhe e siperfaqes pyjore perbehet prej pyjesh me prodhimtari te pakte (dushku dhe shkurre te ndryshme.)
Shtrihen ne lartesinë 230 – 2300 m mbi nivelin e detit dhe kryesisht ndodhen ne krahun e majtë të lumit Vjosa . Sipërfaqa pyjore e bashkisë ndahet në 7 ekonomi pyjore të cilat kanë kufi të qartë natyror.

4: EKONOMIA E PËRMETIT

Bashkia e Përmetit paraqet një zonë ekonomike mikse. Sektorët si bujqësia, blegtoria, agroindustria, turizmi, tregëtia dhe shërbimet përbëjnë drejtimet ekonomike në të cilat popullata lokale është e përfshirë. Për shkak të natyrës mikse të ekonomisë, banorët janë të punësuar në sektorë të ndryshëm si bujqësi, industri dhe shërbime. Struktura e punësimit në këto sektorë paraqitet si më poshtë: në bujqësi janë të punësuar 30.9% e forcës aktive të punës, në industri rreth 18.6%, dhe në shërbime 50.4%, tregues i lartë dhe mbi mesataren e vendit. Të vetpunësuarit përfaqësojnë 30% të forcës aktive të punës. Katër nga njësitë administrative kanë profil bujqësor; tre prej tyre mikse bujqësore (popullsia e angazhuar në bujqësi varion midis 64-84% e krahut të punës), ndërsa vetëm njëra me profil të pastër bujqësor (në bujqësi është e angazhuar më shumë se 84% e krahut të punës). Të gjitha njësitë janë malore duke qenë se terreni është i pjerrët në me shume se 45% te siperfaqes se tij .

4.1 Bujqësia

Edhe pse sektori i shërbimeve përfaqëson shkallën më të lartë të punësimit, bujqësia përfaqëson sektorin kryesor ekonomik edhe pse ajo karakterizohet nga një sërë problemesh. Kryesisht problemet që mbajnë peng zhvillimin e bujqësisë janë parcelizimi i skajshëm i tokës bujqësore. Bujqësia karakterizohet nga ferma shumë të vogla bujqësore, familjare të cilat nuk arrijnë rendimente të larta. Zona e Frashërit duke qenë se është malore kultivon më shumë drurë frutorë dhe është karakterizuar nga shtime të blloqeve të reja të pemëve frutorë ndër vite. Ndërsa, vreshtat janë kthyer në aktivitet tradicional në njësitë administrative të Përmetit, veçanërisht në Petran dhe Qendër Piskovë, duke u favorizuar nga sipërfaqe të konsiderueshme toke që këto njësi kanë. Kultivimi i vreshtave është i lidhur ngushtë edhe me industrinë e përpunimit të rrushit, e cila ka qenë e zhvilluar në Përmet që para viteve ’90.

4.2 Sistemi energjitik

Energjitika ne kushtet bashkohore eshte nje resurs i pa zevendesushem ne kuptim te zhvillimit ekonomik,te ushtrimit te veprimtarive,te ngritjes dhe te mbajtjesne nivel te standartit jetesordhe mireqenies sociale ne pergjithesi.
Furnizimi me energji elektrike Bashkise kryhet nepermjet N /Stacionit elektrik Permet 110/ 10 kë dhe fiderave SMT,Qytet, Ndertim, Kosine, Piskove, Petran 24 ore pa nderprerje.
Per perballimin e situatave emergjentete shkaktuara nga faktore natyrore dhe veprimtaria njerezore, Agjensia OSHEEka hartuar planin e gadishmerise per kete qellim.

4.3 Infrastruktura rrugore

Infrastruktura rrugore eshte pjese perberese e jetes se qytetareve per funksionimin e bazes ekonomike.

Transportimi i mallrave dhe udhetareve ne teritorin e Bashkise zhvillohet nepermjet rrugeve automobilistike.
Rrjeti rrugor perbehet nga rruge nacionale (kombetare) ,rruge lokale dhe rruge rrurale

Tabela : Rrjeti rrugor i Bashkisë

Nr	EMERTIMI RRUGEVE	DISTANCA km	KATEGORIA					
			1	2	3	4	5	6
1	**Permet - Kelcyre**	18	18					
2	Bodar	1	1					
3	Bodar - Degezim	3	3					
4	Puai - Degezim	6	1					5
5	Tremisht - Degezim	8	3					5
6	Lupcke - Degezim	12	3					9
7	Kutal	2	2					
8	Kutal - Degezim	3	3					
9	Ura e Bualit	4	4					
10	Kosine	6	6					
11	Kosine - Degezim	7	6	1				
12	Kryqezim Frasher	8	8					
13	Piskove	9	9					
14	Pacomit	10	10					
15	Rrapi Kuqarit (Grabove)	13	13					
16	Permet - Lipe	3						3
17	Permet - Bual	5						5
18	Permet - Leuse	2.3						2.3
19	Permet - Leshice	7						7
20	Permet - Badlonje	7				7		
21	Permet - Gjinkar	8				8		
22	Permet - Mokrice	12	8					4
23	Alipostivan	14	8			6		
24	Alipostivan - Degezim	17	8			6		3
25	Raban	15	8					7
26	Raban - Degezim	19	8			7		4
27	Pagri	17	8			9		
28	Odrican - Degezim	20	8			9		3
29	Borocke	18	8			9		1
30	Borocke - Degezim	24	8			9		7
31	Kamenckë	23	8			9		6
32	Bunove	27	8			9		10
33	Kryqëzim stacion	29	8			9		12
34	Stacion P. Degëzim	30	8			9		13
35	Kreshovë	34	8			9		17
36	Kreshovë - Degëzim	41	8			9		24

37	Suropull Degëzim	39	8			9		22
38	Frashër	39	8			9		22
39	Miçan - Degëzim	49	8			9		32
40	Vërçisht - Degëzim	49	8			9		32
41	Koblarë - Degëzim	48	8			9		31
42	Zavalan - Degëzim	43	8			9		26
43	**Përmet - Bënjë - Frashër**	41	7			5		29
44	Kryqëzim - Bënjë	7	7					
45	Rezervat	8	8					
46	Lumi Bënjë	12	12					
47	Bënjë	11	7			4		
48	Bënjë - Degëzim	13	7			4		2
49	Ura e Dashit	21	7			5		9
50	Gostivisht	28	7			5		16
51	Kostrec	31	7			5		19
52	Ogren	32	7			5		20
53	Frashër	41	7			5		29
54	**Përmet – Kufi - Leskovik**	36	36					
55	Skutaraq	2	2					
56	Qilarisht	3	3					
57	Qilarisht - Degëzim	5	5					
58	Pasarela e Badlonjës	5	5					
59	Petran	8	8					
60	Trebozisht	11	11					
61	Kaludh	13	13					
62	Strëmbec	16	16					
63	Iljarë	19	19					
64	Draçovë - Degëzim	23	20			3		
65	Zhepë	24	20			4		
66	Çarshovë	28	28					
67	Tri Urat	34	34					

Figura.4 Hartë e sistemit rrugor në bashkinë Përmet.



4.4 Telekomunikacioni

Sistemi I telekomunikacionit në Përmet funksionon në dy mënyra;rrjeti I telefonisë fikse dhe asaj mobile.Në Përmet ka tre operatorë të cilët janë VODAFON,One,TELEKOM.

4.5 Shëndetësi

Sherbimin shendetsor ne Bashkine Permet mbulohet nga sherbimi spitalor dhe NJVKSH.
SHERBIMI SPITALOR (SPITALI PERMET)
Perbehet nga keto reparte:

- Reparti Patologjise
- Reparti kirurgjise
- Reparti pediatrise
- Reparti infektiv

POLIKLINIKA

- Neurologji
- Nefrologji
- Kardiologji
- Endokrinologji
- ORL Okulist

Numri mjekeve specialiste	14
Numri i infermereve	54
Kapaciteti shtreterve	102 (nga keta 25 shtreter reparti lindjes)

Sherbimi urgjences perbehet nga 1 mjek urgjence 1 kryeinfermier 6 infermiere 2 barelmbajtes dhe 6 mjete ambulance.
NJESIA E KUJDESIT SHËNDETËSOR
Sherbimi shendetsor ofrohet nga NJVKSH nepermjet :

- Sherbimi i higjenes dhe Epidemiologjise
- Sherbimi ne qendrat shendetsore ne NJAdministrative

Sherbimi shendetsor ne NJVKSH mbulohet nepermjet higjenes dhe epidemiologjise ku punojne 1 mjek epidemiolog, 2 laburant bakteriologjik, 1 kimist ,3 ndihmes epidemiolog,8 infermiere si dhe 3 stomatologe.
Sherbimi shendetsor nga mjeket e familjes mbulohet nga 5 qendra shendetsore,11 mjeke dhe 56 infermere.
Per funizimin me medikamente dhe pajisje shendetsore do te bazohemi ne rezervate NJVKSH,Spitali Permet dhe farmacive private.
Per sherbimin shendetsor dytesor do te bazohemi ne Spitalin Rajonal Omer Nishani Gjirokaster
Aktualisht ne sherbimin spitalor mungojne mjeket specialist:

- Terapi intensive
- Kardiolog
- Laburant klinike-baktereologjike
- Banka e gjakut.

4.6 Arsimi

Te dhena te pergjithshme ;

Bashkia Permet ka ne juridiksionin e saj 5 institucione arsimore. Nga keto 1 gjimnaz, 1 shkolle te mesme te bashkuar dhe 3 shkolla 9- vjecare.

Gjendja e shkollave ne pergjithesi eshte e mire , kane godina te pershtatshme per zhvillimin normal te mesimit ne perputhje me standartet.

Shkollat vartese qe e zhvillojne mesimin me klasa kolektive, me numer te vogel nxenesish nuk i plotesojne te gjitha kushtet per zhvillimin e mesimit, ato kane nevoje per nderhyrje te pjesshme si ne funizim me uje ,energji elektrike ,si dhe jane konstatuar mangesi ne pajisjet me mjetet e mbrojtjes kundra zjarrit.

Gjate ketij viti nga Bashkia do te merrë masa per eleminimin e ketyre mangesive per sigurimin e kushteve sipas standarteve per zhvillim normal te mesimit.

5:DEMOGRAFIA

Popullsia e bashkisë arrin në 10,614 banorë sipas Census 2011, ndërsa sipas Regjistri Civil 2019 raportohet të jetë 19 456 banorë. Ndryshimi mes dy burimeve është në nivelin e 50% të popullsisë(shih Aneks, tab). Ndërsa, përsa i përket ndarjes së popullsisë sipas gjinive, popullata femër përfaqëson 50% të popullsisë totale. Në nivelin e njësive administrative, përqindja e femrave varion nga 46% në 50%. Përqindjen më të ulët të femrave e ka njësia administrative Frashër. (shih Aneks, tab) Më shumë se gjysma e popullsisë, rreth 56%, jeton në qytetin e Përmetit. Njësia admninistrative me numrin më të vogël të popullsisë dhe që përbën vetëm 4% të totalit të popullsisë së bashkisë së Përmetit është Frashëri. Njësitë e tjera (Çarshovë, Petran dhe Q.Piskovë) përbëjnë 40% të popullsisë së bashkisë. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë numrin e fshatrave për popullsi, mund të thuhet se me përjashtim të qytetit të Përmetit, njëistë e tjera administrative kanë numër të vogël popullsie për fshat, i cili varion nga 48 për Frashër më ulëti, në 100 për Çarshovë, Petran dhe Q.Piskovë. Gjithashtu, duhet përmendur se shumica e territorit të bashkisë shtrihet në terren malor. Një reliev i tillë kushtëzon numrin e lartë të fshatrave dhe dëndësinë relativisht të ulët të popullsisë për fshat. Sipërfaqja e bashkisë është 601.95 km² dhe dëndësia e popullsisë është 33.72 banorë/km². Popullsia e bashkisë dominohet më shumë nga grupmosha 15-64 vjeç, e cila përbën 66% të popullsisë totale dhe që përfaqëson popullsinë aktive për punë (shih Aneks, tab.nr.5) . Mosha e tretë (65 vjeç+) përqafëson 18% të popullsisë, tregues ky qëështë më lart se mesatarja e vendit (11.3%); ndërsa grupmosha 0-14 vjeç përbën vetëm 16% të popullsisë së bashkisë Përmet,tregues ulet ne krahasim me mesataren e vendit(20.7%)%

6:VLERËSIMI I RREZIQEVE

Vlerësimi i rreziqeve përcakton çështjet si:

- Çfare mund të ndodh?
- Sa shpesh mund të ndodh?
- Dëmi që ka mundesi të shkaktohet?
- Sa ka mundesi të ndikojë në komunitet?
- Sa është i cenueshëm komuniteti ndaj rrezikut?

Pesë hapat e procesit të analizimit të rrezikut janë:

- ❖ Identifiko rrezikun.
- ❖ Profilizo secilin rrezik.
- ❖ Ndërto profilin e komunitetit.
- ❖ Përcakto cenueshmërinë.
- ❖ Krijo dhe apliko skenarët

Format standarde për vlerësimin e rreziqeve

A) FREKUENCA E NDODHJES:

- **Shumë e mundshme**: Mundësia afër 100% në vitin e ardhshëm.
- **E mundshme**: Mundësia midis 10 dhe 100% në vitin e ardhshëm, ose së paku në gjasë, në 10 vitet e ardhshme.
- **Ka gjasa**: mundësia midis 1 dhe 10% në vitin e ardhshëm, ose së paku një shans në 100 vitet e ardhshme.
- **E pamundshme**: Mundësia më e vogël se 1% në 100 vitet e ardhshme.
- **Tepër e pamundshme**: Mundësia një herë në 500 vjet.

B) EFEKTI GODITES NE KOMUNITET

NIVELI RREZIKUT	KARAKTERISTIKAT
SHUME E LARTE	▪ Vdekje të shumëllojshme ▪ Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për 30 ditë apo më shumë. ▪ Më shumë se 50% e të mirave materiale të dëmtuara rendë.
E LARTE	▪ Lëndimet dhe/apo sëmundjet rezultojnë në paaftësi të përhershme. ▪ Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për së paku 2 javë. ▪ Më shumë se 25% e të mirave materiale të dëmtuara rendë
E MESME	▪ Lëndimet dhe/apo sëmundjet nuk rezultojnë në paaftësi të përhershme. ▪ Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për së paku nje jave. ▪ Më shumë se 15% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë
E ULET	▪ Lëndimet dhe/apo sëmundjet nuk rezultojnë në paaftësi të përhershme dhe ndihmes se pare ▪ Humbje e vogel e standartit te jeteses ▪ Nderprerja e objekteve /sherbimeve per 24 ore e me pak ▪ Me pak se 10% e te mirave material te demtuara rende

7: RREZIQET DHE RISKU I FATKEQËSIVE NATYRORE

Territori i bashkisë Përmet është i rrezikuar nga një sërë fenomenesh natyrore.Ndër më kryesoret mund të përmendet rreziku sizmik,rreziku i zjarreve masive në pyje e kullota,rreziku i bllokimit të rrugëve nga dëbora,rreziku i rëshqitjeve dhe gryerjeve,i rënies së gurëve,rreziku nga përmbytjet, rreziku nga objekte të ndryshme si pacarela, ura, ndërtesa të abandonuara, etj si dhe ndryshime që mund të vijnë nga dryshimet klimatike.Për secilën nga këto rreziqe më poshtë jepet një përshkim i shkurtër i fenomenit,zonat më të rezikuara,ngjarjet historike,si dhe parashikim I ndodhjes së mundshme të një ngjarjeje të ardhshme të rrezikshme.
Duke ju referuar punës,deri tani është bërë evidentimi .Hartëzimi i rreziqeve është ende në proces. Materiali vijues është një e dhënë e shpejtë e situatës.

Tabela e klsifikimit te rreziqeve ne teritorin e Bashkise .

Nr	Lloji rrezikut	Mundesia e ndodhjes	Efekti	Frekuenca e ndodhjes
1.	Permbytjet , Vershimet	Shume e mundshme	I larte	Mbi 50 % vitin e ardhshem
2.	Zjarret pyjre	Shume i mundshem	I mesem	80 – 100 % vitin e aedhshem
3.	Zjarr ne objekte banimi	Shume i mundshem	I mesem	75 – 90 % vitin e ardhshem
4.	Zjarr ne stacine karburanti	I mundshem	I larte	Deri ne 10 % ne 10 vitet e ardhsheme
5.	Termetet	Ka mundesi	Katastrofik	1-10 % ne 10 vite ose nje ndodhje ne 100 vjet
6.	Stuhite	I mundshem	I ulet	20 – 30 % ne 10 vitet e ardhshme
7.	Erozioni	Ka mundesi	I mesem	10 – 100 % nje mundesi ne 10 vjet
8.	Epidemite	I mundshem	I mesem	10 – 100% nje mundesi ne 10 vjet
9.	Bora	I mundshem	I ulet	10 – 100 % ne 10 vitet e ardhshme
10.	Thatesite	Ka mundesi	I ulet	10 – 100 % nje mundesi ne 20 vjet
11.	Objekte me burim rreziku (objekte te vjetra, ura dhe pacarela etj)	Shume i mundhshem	I larte	10 – 100 % nje mundesi ne 10 vjet

PROFILI I RREZIKUT
Rreziku : Permbytje (Vershime + Erozion)
Madhesia e mundshme : (Perqindja e goditjes se kmunitetit) E mesme 10 - 15%

Frekuenca e ndodhjes : Shume e mundshme : Mundesia deri ne 50% ,se paku 2 here ne vit	Modeli sezonal : Pranvere (Mars – Prill) Vjeshte (Tetr – Nentor) Dimer (Dhjetor – Janar – Shkurt)
Zonat qe mund te goditen me shume : Qyteti Permet (qendra urbane) , Nj.administrative Petran , Piskove	
Kohe zgjatja e mundshme : 2 – 4 dite	
Koha e mundshme e paralajmerimit : 3 – 6 ore	
Sistemet ekzistuese te paralajmerimit : IGJUEM , Sistemi itegruar i lajmerimit 112, Policia e shtetit Permet 129 , sherbimi zjarrfikes dhe shpetimi 128	
A ekziston analiza e dobesive / cenueshmerise ? Jo	

Goditja e faktoreve kyc te komunitetit

PROFILI	PASOJAT E MUNDSHME	SHKALLA E GODITJES
Banoret	Dhjetëra vdekje dhe qindra lëndime të rënda, për shkak të goditjes së valës së ujit, rrënimeve, dhe prurjeve të materialeve të ngurta	E Larte
Pasuria	Në zonat e goditura nga vërshimet uji depërton në oborret dhe shtëpitë e qytetarëve, duke shkatërruar pasurinë, dhe të mirat materiale të qytetarëve	E Larte
Infrastruktura	Dëmtimi i ujësjellësit, kanalizimit, energjisë, tokave të bukës,teknologjisë informative	E Larte
Objekte te rendesise se vecante	Dëmtimi i objekteve shkollore, objekteve qeveritare, rrugëve, urave etj.	E Larte
Ambienti	Për shkak të prurjeve të mëdha të ndryshme, llumit dhe kontaminimit, dëmtohet mjedisi.	E Mesme
Demet ekonomike	Shkatërrim dhe dëmtim i madh i shtëpive, pasurisë, infrastrukturës vitale, etj.	E Mesme
Sherbimet shteterore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë	E Mesme
Sherbimet e emergjences	Dëmtime të pajisjeve të njësive reaguese (operacionale)	E Mesme

IDENTIFIKIMI I RREZIQEVE NGA PERMBYTJET

Duke mare parasysh kushtet klimatike që dominojne në bashkine tone me shtim të reshjeve atmosferike gjatë sezonave vjeshtë- dimer- pranverë,si dhe disnivelit të burimit te lumit e të perrenjeve deri në teritoret urbane me rrjedhë të fuqishme dhe të furishme e sasi të madhe të ujit, mundësi të bartjes së materjalit drunor,guror, rërës dhe zhavorit plus mbeturinat e hedhura të hekurishtave, betonarmes e te automjeteve ,është konstatuar dhe vlerësuar se këta lumej dhe perenje në mënyrë të pashmangëshme do te dalin nga shtrati duke vershuar jo vetëm token bujqesore por edhe rrezikun te njërëzit dhe shtëpitë e tyre.
Dalja nga shtrati i lumut Vjosa rrezikon :

- Demtim te pasarelave , Mesare, Zhepe , Buhal , Kutal
- Permbytje te 300 m segment te rruges nacionale Permet- Carshove ne vendin e quajtur Redhi Badlonjes
- 400 m segment rrugor rural Dracove - Zhepe
- Permbytje te150 m segmentit rugor Ura – Guri Qytetit Permet
- Permbytje 4 objekteve te biznesit pergjat rruges Ura – G. Qytetit
- Permbytje te nje banese ne vendin e quajtur ish karburanti ushtrise
- Permbytje te siperfaqes se tokes bujqesore rreth 3 ha ne vendin Guri Hatos
- Stacionin e pompimit te ujit te pishem, Guri Hatos
- Stacionin e pompimit te ujit te pishem Kosine
- Erozionin ne te dy brigjet e lumit te tokave bujqesore te njesive administrative Carshove , Petran e Piskove
- Muret mbajtese (Pritese) te ndertuara per mbrojtjen nga erozioni pergjate bregut te majte te lumit ne lagjen e Re – L. Bajame – Ura – L. Mejden - pasarela e Permetit.

Vershimi ujrave te perrenjeve ne zonen urbane (Permet)
Perroi Bardhe rrezikon :

- Banesat e lagjes Sede , Teqe
- Bizneset pergjate rruges Lagja Bajame - Tregu Kaleshi
- Permbytje te tregut
- Permbytje te segmentit rrugor Teqe – Tregu , lagja Bajame – Hotel Redi

Perroi Lipes rrezikon :

- Lagjen Mejden
- Spitalin
- Rruget Spitali – Hotel Ramizi , Spitali – Guri Qytetit

Perenjte e Dyshit dhe i ish SMT rrezikon :

- Permbytjen e segmentit rrugor Karburanti – Kryqezimi i rruges per ne Erseke
- Banesen tek ish karburanti i ushtrise
- Dy objekte karburanti dhe nje object biznesi restorant
- Stacionin elektrik

Vershimi i ujrave ne zonat rurale rrezikojne :

- Bllkimin e segmenteve te rugeve rurale qe lidhin njesite administrative me fshatrat
- Erozion te tokave bujqesore
- Erozion te rugeve te fshtrave







PROFILI I RREZIKUT	
Rreziku : Zjarr ne pyje (Siperfaqe te hapura)	
Madhesia e mundshme (Perqindja e goditjes ne komunitet): Mesatare 20 – 30 %	
Frekuenca e ndodhjes : Shume e mundshme . mundesia 100 % se paku dy here ne vit	**Modeli sezonal :** Qershor – Shtator
Zonat qe mund te goditen me shume : Parku Kombetar “ Bredhi Hotoves “, Kurora e gjelbert e	

qytetit te Permetit , Bredhi Petranit.
Kohezgjatja e mundshme : 10 ore deri ne 2 dite
Shuma e mundshme e kohes se paralajmerimit : 6 – 12 ore
Sistemet ekzistuse te paralajmerimit : IGJEUM , Sistemi integruar 112 , Sherbimet e informacionit te pol. Shtetit . MZSH
Aekziston analiza e dobesive / cenueshmerise : Po

Cenueshmeria nga goditjet ne faktoret kyc te komunitetit

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banore	Shkalla e goditjes në banorë gjatë kohës së zjarrit në vendin e ngjarjes e larte(vdekje , lendime te renda per shkak te afersise me qendrat e banuara)	**E Larte**
Pasuria	Demtim i pasurise , shteterore e private	**E Larte**
Infrastruktura	Demtimi I linjave percjellese elektrike	**E Mesme**
Objekte te rendesise se vecante	Mungesa e objekteve te rendesise se vecante dhe infrastructures ne zonat pyjore	**E Ulet**
Demet ekonomike	Shkaterimi masivit pyjor , erozini , Ripyllezimi	**E Larte**
Ambienti	Për shkak të zjarreve të mëdha dhe tymit dëmtohet mjedisi si dhe krijohen parakushtet për erozion masiv	**E Larte**
Trashegimia kulturore	Demtimi I objekteve te trashegimise kulturore ,dëmtimi i vegjetacionit, flora, fauna, speciet e veçanta dhe pikat turistike	**E Larte**
Sherbimet shteterore	Nuk ka infrastructure qe mund te demtoje sherbimet	**E Ulet**
Sherbimet emergjente	Demtime te pajisjeve te sherbimeve te forcave operacionale	**E Ulet**






IDENTIFIKIMI I ZONAVE ME RREZIK NGA ZJARRET

Nga zjarret ne pyje :

- Pargu Kombetar " Bredhi Hoyoves "
- Kurora e gjelbert e qytetit Permet (Bual , Permet, Leuse , Lesshice, Qilarisht ,Bdar Kutal ,Kosine)
- Bredhi Petranit
- Grumbulli pyjor i pishave Iljare nj.ad.Carshve
- Grumbulli pyjor i pishave m. Kallarytos nj.ad.Carshove
- Pyjet e dushkut ne zonen e rrezes

Nga zjarret ne Objekte :

- Ne banesa (qendra te banuara)
- Ne stacione e pika te furnizimit me karburant dhe gaz (Qytet dhe ne periferi te Permetit)
- Nenstacioni elektrik dhe fiderat
- Objektet ku kryhet veprimtari prodhuese
- Bjektet kolektive (Shkolla , kopshte , nadertesa administrate , spitali e qendrat shendetesore etj)
- Ne objekte biznesi

Nga Zjarret ne fusha :

- Fushat , e Carshoves ,Kaludhit , Qilarishti, Kosine , Piskove.

Zjarret ne :

- Ne vareza te qytetit dhe te fshatrave
- Ne vendgrumbullimin e mbetjeve , Guri Hatos , Kutal

PROFILI RREZIKUT	
Rreziku: Rrëshqitjet dhe rrokullisjet e masave shkembore	
Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet): E Larte.	
Frekuenca e ndodhjes: E mundshme.	Modeli sezonal: Pranveror : Mars dhe Prill. Vjeshtor : Tetor, Nëntor. Dimëror : Dhjetor , Janar dhe Shkurt.
Zonat që mund të goditen më së shumti: Zonat te pa qendrueshme të lidhura me ndërtimin gjeomorfologjik të terrenit, rënia e theksuar e shtresave të shkëmbinjve që e ndërtojnë vendndodhjen , vegjetacioni, ujërat sezonal edhe ata të përhershëm.	
Kohëzgjatja e mundshme: Relativisht e shkurt 3 - 4 ditë; Relativisht e gjatë- disa muaj; E gjatë disa dhjetra vite me disa nderprerje të lëvizjeve të masave shkembore	
Shpejtësia e mundshme e ndodhjes (E mundshme e kohës së paralajmërimit): Paralajmërim minimal (ose fare). Paralajmërim 6 deri 12 orë. Paralajmërim 12 deri 24 orë. Paralajmërim më shumë se 24 ore	
Sistemet ekzistuese të paralajmërimit: Numri i integruar 112.	
A ekziston analiza e dobesive / cenueshmeria : Po	

Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit.

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banoret	Vdekje, lëndime apo sëmundje që rezultojnë në paaftësi të përhershme	E larte
Pasuria	Shkatërrime/ dëmtime të objekteve të banimit,rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit,et	E larte

Infrastruktura vitale	Shkatërrim / dëmtim i infrastrukturës rrugore, rrjetit elektrik dhe telekomunikimit, etj.	E larte
Ojektet e rendesise se vecante	Shkatërrim / dëmtim i objekteve shkollore, QMF, objekteve te institucioneve shteterore, etj.	E larte
Shërbimet emergjente	Dëmtime të pajisjeve të njësive operacionale.	E mesme
Ambienti	Degradim i mjedisit.	E larte
Trashëgimia kulturore	Shkatërrim/ dëmtim i objekteve të kultit (fetare)	E larte
Shërbimet shtetërore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë.	E mesme
Dëmet ekonomike	Shkatërrim / dëmtim i madh i shtëpive, pasurisë, infrastrukturës , etj.	E larte

Zonat me rrezik rreshqitje
Rrezik rreshqitje me shembje te banesave :
Jane identifikuar ne fshatrat : **Biovizhde , Badlonje Lipe e Vjeter , Piskove , Gjinkar , Bual , Rapcke.**
Rrezik rreshqitje me rrokullisje :
Ne segmentin rrugor te rruges nacionale Kelcyre – Permet - Tri Urat ne ne vendet **: Redhi Badlonjes, Iljare , Kthesat e Zhepes .**
Ne rrugen rajonale **Permet –Frasher – Ogren – Petran**
Ne rruget rurale te fshatrave ten nj.administrative **Piskve , Frasher , Petran , Carshove**
Rrezik i rreshqitjes se tokes ne te dy anet e lumit Vjosa :
Fushat e njesise administrative Carshove: **(Carshove ,Zhepe, Dracove Iljare ,Stermbec.)**
Fushat e njesise administrative Petran **: (Gjinkar ,Badlonje ,Qilarisht, Leshice)**
Fushat e njesise administrative Piskove**:(Piskove , Kosine , Rapcke , Bual , Kutal .)**

Zonat me rrezik rreshqitje e rrokullisje guresh

Ne njesine administrative Permet **:Masat shkembore Kodra e Bolenges (Boleng – Depua e ujit)**
Ne njesine administratve Petran : **Masat shkembore ne VL te fshatit Gjinkar**
Ne njesine administrative Carshove **: Masat shkembore ne perendim te fshatit Zhepe**

Renia e shkembinjeve eshte karakteristike ne shpatet e malit te Nemerckes


Masiv shkembor mbi depon e ujit Permet. Eleminuar ne shpertrim te
kontrolluar nga njesia speciale e xherios MM 17 - 18.11.2017







RREZIKU NGA BORA

IDENTIFIKIMI RREZIKUT	
Kategoria e rrezikut	Atmosferike
Lloji	Fatkeqesi natyrore
Rreziku :	Rreshjet e bores
Modeli :	Stinor (stina e dimrit) Dhjetor – Janar - Shkurt
Vendndodhja :	Kryesisht zonat malore te teritrit te bashkise

Ngjarjet e mumdshme rrezikuese tipike te debores jane ;

I. Bllokimi popullsise
II. Bllokimi infrastruktures

Reshjet e dëborës ne teritorin e bashkise janë karakteristike për zonat malore malore, ndersa ne luginen e Vjoses ato jane dukuri e rralle . Reshjet e dëborës, kur janë në sasi të mëdha, përveçse mund të shkaktojnë emergjencë për banorët e zonave që preken drejtpërdrejt për shkak të bllokimit për një kohe të gjatë të tyre, janë pengesë serioze edhe për komunikimin në përgjithësi. Sigurimi i lëvizjes së pandërprerë ka rëndësi jetike për një operacion emergjence.
Strukturat planifikuese, menaxhuese dhe vendimmarrëse te bashkise kanë nevojë për këto informacione:

- zonat ku potencialisht pritet bllokimi dhe kushtet në të cilat ndodh bllokimi,
- nëse bllokimi ndodh, sa do të zgjatë ai

Zonat me te rrezikuara ku potencialisht pritet te ndodhe bllokimi nga bora i popullsise dhe infrastruktures jane :

- Njesia administrative Frasher (fshatrat ; Frasher , Mican , Vercisht ,Kreshove , suropull, Zavalan ,Ogren, Gostivisht) Gjithesej 60 familje, banore 180
- Njesia administrative Piskove (Raban , Borocke , Hotove ,Mokrice , Zleushe .) Gjithesej 25 familje ,80 banore
- Njesia administrative Petran (Tremisht , Benje , Ogdunan, Lipivan) Gjithesej 15 familje , 40 banore
- Rruga rajonale Piskove – Frasher – Ogren – Petran
- Rruget rurale qe lidhin qendrat administrative me keto fshatra.

Trashësia e mbulesës së dëborës prej 10 cm sjell një shtresë akulli me trashësi 5mm, që është e mjaftueshme për të ndërprerë trafikun normal dhe prek, madje pengon (në zonat malore), operacionet e emergjencës. Megjithatë, grumbullimi i dëborës rreth 25-30 cm e bllokon tërësisht qarkullimin e makinave të zakonshme. Në rast se nuk bëhet pastrimi rregullisht prej dëborës, sidomos në zonat malore veri – lindore te bashkise , trafiku mund të bëhet vetëm me automjete të posaçme, të cilat, sot për sot, janë të kufizuara .

Bllokimi i popullsisë – rreziku dhe elementët e parapërgatitjes

Mundësia e bllokimit të popullsisë nga dëbora, llogaritet si popullsi banuese brenda konturit të hapësirës që mbulohet me dëborë, me lartësi të paktën 30 cm. Duke mbajtur parasysh rezervat e ushqimit brenda shtëpive

dhe të furnizimeve të tjera, një periudhë bllokimi më e gjatë se 30 ditë duhet të quhet kritike për planifikimin e parapërgatitjes për emergjencë.
Duke u mbështetur në regjistrimet për periudha të gjata, tregon se rreziku ne keto zona mbetet nën mbulesën e dëborës të paktën për 5 – 15 dite
Rreshjet e bores, shkaktojnë një numer problemesh në jetën e përditëshme dhe në punë. Ato arrijne deri të ndërprerja e komunikacionit rrugor në rajonet urbane e sidomos në rajonet rurale, duke vështirësuar zhvillimin normal të jetës e punës në zonat e përmendura, e cila pasqyrohet në veshtirësimin e furnizimit të banorve me artikuj jetësor, veshtiresimin e qasjes së objekteve të ndryshme publike si shkollave, enteve shëndetësore, të punës dhe atyre ekonomike. Në situata të tilla, shpesh arrin deri të prishja në linja elektrike, sistemin e ujësjellësit dhe objekte tjera ifrastrukturore qe shkaktojnë ndërprerje të shpeshta në furnizimin e objekteve banese dhe objekteve tjera. Nderprerjet e punes ne institucione e shkolla zgjatjen e kane me se shumti 2-3 dite. Në terë teritorin e bashkise, organizohet mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale dhe rrugëve tjera të pa kategorizuara, të cilat janë nën autortetin e bashkise dhe te njesive administrative. Ndersa rruga nacionale mirembahet nga ARrJugor nepermjet firmave kontraktore .









PROFILI I RREZIKUT	
Rreziku : Objekte me burim rreziku (objekte te vjetra, ura dhe pacarela etj)	
Madhesia e mundshme : (Perqindja e goditjes se kmunitetit) E larte 10 – 100 %	
Frekuenca e ndodhjes : Shume e mundshme : Mundesia deri ne 50% ,se paku 2 here ne vit	Modeli sezonal : Pranvere (Mars – Prill) Vjeshte (Tetr – Nentor) Dimer (Dhjetor – Janar – Shkurt)
Zonat qe mund te goditen me shume : Qyteti Permet Nj.administrative	
Kohe zgjatja e mundshme : cdo dite	
Koha e mundshme e paralajmerimit : 1 ore	
Sistemet ekzistuese te paralajmerimit : Sistemi itegruar i lajmerimit 112, Policia e shtetit Permet 129 , sherbimi zjarrfikes dhe shpetimi 128	
A ekziston analiza e dobesive / cenueshmerise ? Jo	

Goditja e faktoreve kyc te komunitetit

PROFILI	PASOJAT E MUNDSHME	SHKALLA E GODITJES
Banoret	Personat që bashkëveprojnë dhe janë të ekspozuar me rreziqet janë banorë të fshatrave si dhe banorë të qytetit të Përmetit të cilët përdorin në përditshmëri këtë infrastrukturë.	E Larte
Pasuria	Situatat e rrezikshme të cilat krijonen për rastin tonë janë, mundësia e lartë e rrëzimit të personave apo gjësë së gjallë në ujërat e lumit Vjosë, vështirësia e kalimit si rezultat i demtimeve të shumta në shtresën e pacarelave. Shkaterimi perfundimtare i pasurise ne rastet e ndertimeve te vjetra.	E Larte
Infrastruktura	Dëmtimi i urave lidhese midis fshatrave dhe infrastruktures rrugore. Demtim i ndertesave te vjetra mund te shkaktojne dhe bllokim te rrugeve ne lagje apo fshatra.	E Larte
Objekte te rendesise se vecante	Dëmtimi i objekteve qeveritare, rrugëve, urave, pacarelave, etj.	E Larte
Ambienti	Për shkak të rezimeve të ndryshme, dëmtohet mjedisi.	E Mesme
Demet ekonomike	Shkatërrim dhe dëmtim i madh i shtëpive, pasurisë, infrastrukturës vitale, etj.	E Mesme
Sherbimet shteterore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë.	E Mesme

Sherbimet e emergjences	Dëmtime të infrastruktures të njësive reaguese (operacionale)	E Mesme

IDENTIFIKIMI I RREZIQEVE NGA OBJEKTE ME BURIM RREZIKU (OBJEKTE TE VJETRA, URA DHE PACARELA ETJ)

Duke mare parasysh faktoret atmosferik, vjetersine ne moshe te objekteve si dhe te urave dhe pacarelave, perdorimin e shpeshte infrastruktures, kushtet klimatike që dominojne në bashkine tone me shtim të reshjeve atmosferike gjatë sezonave vjeshtë- dimer- pranverë, ,është konstatuar dhe vlerësuar se këto objekte dhe infrastrukture në mënyrë të pashmangëshme do te jene te rezikuara per shembje duke rrezikuar jete te njërëzit, gje e gjalle dhe pasurite e tyre.
Objektet kryesore te identifikuara jane:
Pacarelat dhe urat e varura mbi lumin Vjose ne Buhal, Kutal, Permet, Leshice, Mesare, Rapcke, Pellumbar, Zhepe, Vllapsillotere, Grabove, Badelonje, Petran, si dhe ura te shkurtera ne Frasher, Gostivish, Benje, Kanikol, Pagri.
Objekte te vjetra qe rrezikojne shembjen jane banesat te abandonuara ne fshatra dhe qytetin e Permetit, ndertesa shteterore pafunksion te cilat jane drejt degradimit total.

Shkalla e pasojave

A	të parëndësishme	dëmtime materiale (shumë të lehta).
B	të vogla	dëmtime të lehta dhe të përkohshme të shëndetit të banorëve dhe gjësë së gjallë (të kthyeshme).
C	serioze	dëmtim serioz i shëndetit që kërkon kujdes mjekësor dhe trajtim të zgjatur të vazhdueshëm.
D	madhore	dëmtim serioz i përhershëm dhe/ ose progresiv i shëndetit, dalja jashtë funksionit dhe përdorimit I infrastrukturës, humbja e gjësë së gjallë.
E	katastrofike	vdekje





PROFILI I RREZIKUT	
Rreziku : Shperthim dige	
Madhesia e mundeshme (Perqindja e komunitetit qe mund te goditet): E larte	
Frekuenca e ndodhjes : E mundshme	**Modeli :** Gjate vitit
Zonat qe mund te goditen me shume : Kosine , Qilarisht , Strembec	
Kohe zgjatja e mundshme :1 – 2 dite	
Koha e mundshme e paralajmerimit : Pa paralajmerim ose paralajmerim minimal	
Sistemet ekzistuese te paralajmerimit : Nuk ka .	
A ekziston analiza e dobesive / cenueshmeria ? Po	

Cenueshmeria nga goditjet ne faktoret kyc te komunitetit

PROFILI	PASOJAT E MUNDSHME	SHKALLA E GODITJES
Banore	Vdekje , lendime te renda ,permbytje masive	E Larte
Pasuria	Shkatërrim /dëmtim i pasurisë private dhe publike	E Larte
Infrastruktura vitale	Shkatërrim / dëmtim i rrjetit energjetik ,ujësjellësit dhe kanalizimit, infrastruktura rrugore , etj.	E Larte
Demet eknmike	Shkatërrim / dëmtim i përgjithshëm i zonës së goditur	E Larte
Ambienti	Shkatërrim / dëmtim i mjedisit.	E Larte
Trashgimia kulturore	Shkatërrim/ dëmtim i trashëgimisë kulturore, në objekte dhe arkeologji	E Larte
Sherbimet shteterore	Dëmtim /paralizim i infrastrukturës shtetërore.	E Larte
Sherbimet emergjente	Shkatërrim/ dëmtim i pajisjeve të shërbimeve operacionale emergjente	E Larte

Pronat materiale qe jane te ekspozuara , perfshijne : Shtepi banimi , strehime per kafshet , objekte biznesi , toke bujqesore te kultivuar , infrastructure rrugore , sisteme kanalizimi etj.
Shumica e defekteve te konstatuara lidhen me :

- Problemet e shpatit (rreshqitje ose demtime .**Rezervuari Pacomitit**)
- Trupit te diges (zgjerim i diges , plasaritje , deformim i diges , rrjedhje , deportime . **Rezervuari Pacomitit**)
- Keqfunksionim ose demtimin e instalimeve per largimin e ujit (demtim te sistemit hidraulik , demtime ose bllokime te sistemeve te daljes se ujit . **Rezervuari Qilarishtit**)
- Depozitimi i sedimenteve prej rjedhjes se perroit (**Te gjithe rezervuaret**)

Nje pjese e digave kane nevoje dhe vuajne nga problemet e vjetersise , disa kane mungesa teknike dhe te gjitha vuajne nga mungesa e mirembajtjes . Nje pjese e mire e tyre kane nevoje per nderhyrje , ku pervec fondeve te mirembajtjes kerkojne nje modifikim te ndjeshem per permiresimin e tyre (**Rezervuari**

Qilarishtit)

Emergjencat e lidhura me digat e rezervuarve ne bashkine Permet qe kercenojne jeten e popullsise poshte tyre nuk njihen . Defektet e percaktuara dhe keqfunksionimi i disa elementeve te diges ne vecanti nuk jane aq te medha sa per te shkaktuar ndonje katastrofe me pasoja te renda gjate regjimit te rregullt te shfrytezimit te ketyre instalimeve , nga pikepamja e grumbullimit ne kohe ato e shtojne ndjeshem potencialin e pergjithshem . Ne rast te nje ndikimi te madh te agjenteve te tjere negative natyrore,si termeti me zgjatje te madhe dhe i fuqishem , dobesite e percaktuara fare lehte mund te kthehen ne shoqerues te medhenj te fatkeqesise sidomos per per rezervuaret **e Qilarishtit dhe Strembecit**

Rreziqet nga carja e digave lidhet me :

- Prishja e pjeseshme ose totale strukturore te diges me mbushje dheu ose guri te shkaktuar nga rjedhja e ujit neper trupin e diges si pasje e daljes se tij si rrjedhe , krisjes se diges ose ndonje prishje e madhe e shpatit te diges.
- Kapercimin e kreut te diges per shkak te kapacitetit te pa mjaftueshem te largimit te ujit, te rreshqitjeve te medha te dheut ne rezervuar , te gabimeve ne vprime etj.


Parametrat kryesore te carjes / prishjes se diges jane ; koha e carjes ,trajta e carjes ,thellesia e carjes dhe shpejtesia e shenbjes se elementeve te diges . E pebashketa e dukurive te renditura per carjen e diges eshte permbytja eshte permbytja e menjehershme nga perhapja tatepjete e nje dallge me energji te madhe . Ky eshte rreziku me i madh i carjes se diges per popullsine poshte dhe pronen material. Ka dhe rreziqe te tjera , por permbytja e menjehershme tatepjete eshte dukuria me pamjen me katastrofike dhe me pasojat me te renda per zonat poshte digave te rezervuareve.

Parametrat e dallges se permbytjes varen nga :

- Tipi diges
- Gerryeshmeria e trupit te diges ose pritesve ne rast se uji kapercen nga siper.
- Vellimi dhe energjia e ujit qe del
- Dinamika e rjedhjes tatepjete te dallges permbytese

Shkaqet natyrore antrapogjenike qe mund te sjellin ngjarje te tilla te skajshme jane :

- Rreshqitja e madhe e menjehershme e dheut brenda rezervuarit
- Nje termet i forte
- Ardhja e ujerave permbytese per nje katastrofe , veprimi te cilave nuk mund te asnjansohet prej veprimeve te mundshme ne sistemin e diges se rezervuarit.
- Gabime te ndjeshme ne projektin e diges gjate ndertimit ose punes se saj.
- Aktet teroriste



NR	EMERTIMI UJEMBLEDHESIT VENDNDODHJA	VITI NDERTIMIT	KAPACITETI 000 m^3	GJENDJA DHE CFARE RREZIKON
1.	PACOMIT	1984	100	Ujëmbledhësi Pacomit është jashtë përdorimit pasi ka filtrime të shumta në digë. Për vetërrezikshmërinë që paraqet është rekomanduar mbyllja deri në riparimin e tij pasi rrezikon fshatin Pacomit.Saraqineska e shkarkimit është nërregull dhe do lihet hapur gjatë gjithë kohës.Për mosmbushjen e tij është urdhëruar prerja e të gjithë burimeve të furnizimit si dhe mbushja e tij deri në 2 m mbi nivelin e ujëlëshuesit.Ky ujëmbledhës

				duhet të mbahet në monitorim të vazhdueshem nga personi përgjegjës në fshat, nga bordi i ujitjes dhe kullimit dhe njësia administrative Piskovë. Rezikon: banesa dhe toka bujqesore
2.	KOSINE	1969	350	Uëmbledhësi Kosinë,është në gjëndje pune,shkarkuesi katastrofik është në rregull,diga është e pastër ,nuk ka filtrime në digë,rrjeti shpërndarës i ujitjes është nërregull.Ujëmbledhësi administrohet nga shoqata e fshatit Kosinë. Rezikon : 6 banesa te lagjes ish.rep. usht te fshatit Kosine, 30 ha toke bujqesore. 1.5 km rruge automobilistike dhe stacionin e pompes se ujit te pishem te fshatit Kosine.
3.	VERCISHT	1977	180	Ka filtrime ne dige. Jashte funksionit Nuk perbene rrezik
4.	FRASHER	1984	57	Ka filterime ne dige. Jashte funksionit Nuk perbene rrezikshmeri
5.	QILARISHT	1975	170	Ujëmbledhësi Qilarisht,është në përdorim por është bllokuar vepra e marrjes se ujit (Shkarkuesi i bllkuar pasi eshte mbushur me balte).Uji meret nga lart digës me tuba të cilët zhyten në sipërfaqen e ujëmbledhësit.Shkarkuesi katastrofik është nërregull,diga nuk ka filtrime por nuk është e pastruar.Poshtë digës janë ngritur kasolle bagëtish.Rrjeti i kanalizimeve shpërndarëse është në gjëndje të keqe.Ujëmbledhësi administrohet nga shoqata dhe është mbushur. Rrezikon : 2 biznese , 5 kasolle bagetish te fshatit Qilarisht ,30ha toke dhe 1.5km rruge automobilistike.
6.	TREMISHT	1986	150	Ujëmbledhësi Tremisht është në gjëndje pune,shkarkuesi katastrofik është nërregull,diga është e pastër.Ujëmbledhësi administrohet nga shoqata dhe shërben për fshatin Tremisht dhe Qilarisht. Nuk perbene rrezikshmeri
7.	STREMBEC-KALUDH	1972	200	Ujëmbledhësi Strëmbec është në gjëndje pune,shkarkuesi katastrofik është nërregull ,diga është e pastër dhe nuk ka filtrime të ujërave nëntokësore,kanali i furnizimit me ujë është rregullt .Ujëmbledhësi administrohet nga shoqata dhe shërben për ujitjen e dy fshatrave Strëmbec dhe

				Kaludh. Rrezikon : 15 banesa te lagjes Tabor te fshatit Strembec, 1 km rruge automobilistike dhe 15ha toke bujqesre
8.	ZHEPE	1985	40	Ujëmbledhësi Zhepë,është jashtë përdorimit,nuk funksionon saraqineska për vaditje,diga ka filtrim të ujërave nëntokësore,shkarkuesi katastrofik është nërregull por ka nevojë për pastrim,diga është e pa pastruar dhe kanë mbirë pemë.Ky ujëmbledhës është jashtë kontrollit si nga njësia administrative ashtu dhe nga bordi i kullimit dhe ujitjes.Ujëmbledhësi është i mbushur. Nuk perbene rrezikshmeri
9.	ILJARE-3	1975	180	Ujëmbledhësi Iljarë,është në gjëndje pune,shkarkuesi katastrofik është nërregull,diga është e pastruar por ka filtrime ne dige të ujërave nëntokësore.Ujëmbledhësi administrohet nga shoqata e fshatit Iljar dhe Pëllumbar. Nuk perbene rrezikshmeri
10.	KRESHOVE	1977	45	Ka filterime ne dige Nuk perbene rrezikshmeri

PROFILI I RREZIKUT	
RREZIKU : TERMET	
Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet): **Kritike**	
Frekuenca e ndodhjes: E mundshme: Mundësia midis 10 dhe 100% në vitin e ardhshëm, ose së paku mund te ndodh në 10 vitet e ardhshme.	**Modeli sezonal** Ne cdo stine. Mundesia e perseritjes se termeteve me magnitutë Ms = 5,0 kanë periudhë përsëritje prej 3.6 vjetësh (me ± 1 σ vlerësimet janë 3-4.6 vjet), ndërsa tërmetet me Ms = 5.5, 6.0, 6.5 dhe 7.0 kanë periudhë përsëritje 10, 29, 94 dhe 505

	vjet, respektivisht Nga pikëpamja probabilitetit, ka 75 për qind shans që Shqipëria të preket: çdo vit, nga një tërmet me magnitutë jo më të lartë se Ms = 4.7; një herë në 50 vjet nga një tërmet me magnitutë jo më të madhe se Ms = 6.1; një herë në 100 vjet nga një tërmet me magnitutë jo më të lartë se Ms = 6.4.
Zonat qe mund te goditen : Gjithe teritori bashkise Permet	
Kohe zgjatja e mundeshme : E castit (Nga disa sekonda deri ne nje minute)	
Shpejtësia e mundshme (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit): Pa paralajmërim	
Sistemet ekzistuese të paralajmërimit: Nuk ka	
A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë? o Po	

Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit

PROFILI	PASOJAT E MUNDESHME	SHKALLA E GODITJES
Banoret	Dhjetëra vdekje, qindra lëndime të rënda dhe trauma	E larte
Pasuria	Shkatërrim / dëmtim i pasurisë publike dhe private	E larte
Infrastruktura	Shkatërrim /dëmtim i rrjetit: rrugor, të ujësjellësit dhe kanalizimit, energjetik, telekomunikacionit, etj	E larte
Objektet e rendesise se vecante	Shkatërrim /dëmtim i ndërtesave të administratës, bankat, zyrat, objektet shkollore, shendetesore ,objektet qeveritare, dyqanet, qendrat tregtare, restorantet, etj.	E larte
Demet ekonomike	Shkatërrim /dëmtim i pasurisë publike dhe private .	E larte
Mjedisi	Dëmtim / degradim i mjedisit për shkak të derdhjeve të ndryshme, gazrave dhe tymit,	E larte

	kontaminim i ajrit, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, tokës pjellore, ushqimit dhe kafshëve.	
Trashegimia kulturore	Demtim i objekteve te trashegimise kulturore	E ulet
Sherbimet shteterore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë.	E mesme
Sherbimet emergjente	Dëmtime të mjeteve dhe pajisjeve të shërbimeve reaguese emergjente.	E mesme

Vlerësime të riskut sizmik ne ndertesat e banimit

Si bazë për vlerësimin e dëmtueshmërisë dhe të rrezikut për fondin e ndërtesave të banimit shërbejnë të dhënat e regjistrimit të popullsisë të bërë nga INSTAT-i, 2011.

• Materialit të ndërtimit (qerpiç, tullë, gur dhe betonarme [BA]) dhe sistemeve strukturore (mure mbajtëse, parafabrikate, skelet BA);

• Moshës, d.m.th. periudhës së ndërtimit (para vitit 1960: pa rezistencë kundrejt tërmeteve; 1960-1990: me mbrojtje të ulët sizmike; pas 1990-s: me mbrojtje të pamjaftueshme); (3) lartësisë së ndërtimit, d.m.th. numrit të kateve (1-2 kate, 3-5 dhe >5). Për elementet në rrezik të formuluar - 54 gjithsej – analizat e dëmtueshmërisë janë kryer për tri gjendje dëmtimi karakteristike:

• Aspak- shënohet me K-D&P-I;

• E rëndë - shënohet me K-D&P-II;

• Totale - shënohet me K-D&P-III. Ndërsa ndërtesat me K-D&P-I (ose shkallët e dëmtimit D1 dhe D2) mund të përdoren pa asnjë kufizim pas një tërmeti, ato me K-D&P-II (ose D3 dhe D4) duhen zbrazur, duke shkaktuar përkohësisht mbetjen e njerëzve pa shtëpi dhe nevoja për strehim të tyre. Ndërtesat K-D&P-III (ose D5) shkaktojnë dëme në njerëz (vdekje ose plagosje). Për periudhat e pranuara të përsëritjes së tërmeteve prej 50, 100, 200 dhe 475 vjetësh, pasojat e ngjarjes së skenarit paraqiten në tabelën 5 sipas numrit të pritshëm të ndërtesave të dëmtuara (D3 dhe D4) që duhen zbrazur dhe ndërtesave të dëmtuara totalisht dhe/ose të shembura (D5).

Demtimet e njerezve ne ndertesat e banimit – Elementet ne rrezik

Lidhja ndermjet demeve ne njerez dhe shembjeve strukturore merr parasysh parametra te tille si ; sasia e banoreve ne ndertese , sasia ne kohen e termetit , pjesa e banoreve qe ngecin brenda nga shembja strukturore , perhapja e lendimeve ne castin e shembjes dhe vdekjet pas shembjes . Nepermjet nje faktori te vdekjeve pas shembjes modeli perfshine dhe aftesine e kerkimit dhe te shpetimit te sistemit te emergjencave civile

Modeli me perzgjedhje prej kater pikash :

I1 - Lendime te lehta

I2 – Lendime vetem per shtrime ne spital

I3 - Lendime qe kerkojne vemendje te menjehereshme mjekesore e me pas shtrim ne spital

I4 – Vdekje dhe te plagosur per vdekje .

Tipologjia mbizoteruese e lendimeve qe kerkojne vemendje te menjehereshme mjekesore (lendimet I3) jane lendime te indeve te buta (plage dhe kontuzione) thyerje gjymtyresh dhe lendime te kokes .
Ndertesat me sisteme strukturore te demtuara (grada e demtimit D3 dhe D4) nuk jane te sigurta per tu perdoruur menjehere pas nje termeti te forte . Ato duhen zbrazur dhe per popullsine e nxjere jashte duhet te sigurohet strehim i perkohshem . Keto ndertesa trajtohen si perkohesisht te paqendruashme , pasi rimkembja e tyre fizike eshte e perligjur nga ana ekonomike . Ndertesat qe kane pesuar demtim total ose qe kane pesuar shembje (grada e demtimit D5) shkaktojne deme tek njerezit . Ato duhet te trajtohen si te paperdoreshme pergjithmone.

Figura 7.Hartat e tërmeteve




Fig. 4 Hartat e ngjarjeve të mundëshme të rrezikut sizmik për tërmete skenari me periudhë rikthimi 200 vjet

8:REDUKTIMI I RISKUT NGA FATKEQËSITË PËRMES POLITIKAVE DHE INSTRUMENTAVE SEKTORIALË.

Aftësia ripërtëritëse është aftësia e sistemit,komunitetit apo shoqërisë së ekspozuar ndaj rreziqeve për të rezistuar,thithur,akomoduar,për t'u përshtatur,transformuar dhe për t'u rimëkëmbur nga efektet e një rreziku në kohën e duhur dhe në mënyrë efikase.Tashmë ajo është kthyer në një koncept drejtues për politikbërjen e lidhur me zhvillimin dhe veçanërisht përsa I përket riskut të fatkeqësive.

Koncepti I aftësisë ripërtëritëse është *gjithëpërfshirës* ,mbi të gjitha dimensionet e riskut të fatkeqësisë,duke përfshirë rreziqet,eksopzimin,cënueshmërinë dhe kapacitetin përballues.lidhur me personat,komunitetet,vendet dhe pasuritë e tyre.

Aftësia ripërtëritëse është *shumëdimensional* duke përfshirë jo vetëm rindërtimet inxhinjerike për infrastrukturën fizike në territor por dhe për përmirësimin e mjeteve të jetesës ,të shëndetit,të aseteve ekonomike ,fizike dhe faktorëve social dhe ekologjik. Aftësia ripërtëritëse dhe reduktimi I riskut të fatkeqësive kanë marrë një vëmendje të rëndësishme në nivel global. Kjo e shprehur qartë në prioritetet e Kuadrit Sendai,në Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara,në Axhendën e Re Urbane(UN Habitat,2016). Të gjiha këto dokumente strategjike globale vendosin një theks të rëndësishëm dhe tek autoritetet vendore duke qënë se impakti më I madh I krizave është në nivel lokal''ku vdekshmëritë dhe humbjet nga fatkeqësitë janë përballuar me rritjen e nivelit të shpenzimeve të mundshme të fshehura dhe sfidat për të përmbushur detyrimet financiare''.

Si rrjedhojë ,institucionet vendore duhet të jenë të pregatitura si nga ana e kapaciteteve njerëzore, financiare e teknike ashtu edhe nga pikëpamja e instrumentave të cilët përdoren për të qeverisur territorin.

Bashkia Përmet ka të hartuar një plan emergjencash, I cili bazuar në kriteret e reja ligjore,do të rishikohet periodikisht pasi më shumë rëndësi I është kushtuar kapaciteteve reaguese dhe ka patur një shkëputje midis reduktimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë dhe Mbrojtes Civile.

Aktualisht, bashkia Përmet ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV), planin e zhvillimit të territorit dhe strategjinë territoriale. Ky është I vetmi dokument, i cili është në fuqi dhe ka lidhje të drejtpërdrejtë me reduktimin e riskut. Plani i Përgjithshëm Vendor I bashkisë Përmet ka një trajtim të mirë nga pikëpamja e evidentimit të problemeve, rreziqeve me të cilat përballet territori dhe komuniteti. Veçanërisht në infrastrukturën rrugore,administrimin e ujit, në masat dhe infrastrukturën e nevojshme për mbrojtjen nga lumenjtë,përrenjtë,infrastrukturën e energjisë,trajtimin e mbetjeve urbane dhe mbrojtja e mjedisit.Por në krahun tjetër,qasja e PPV ndaj riskut dhe politikat për të ritur aftësinë ripërtëritëse janë të kufizuara. Kryesisht kësaj çështje I jepet zgjidhje nga pikëpamja e projekteve infrastrukturore në vendbanime,arsim/social/kulturë,infrastrukturë të rrjetit rrugor,të trajtimit të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza,energjia dhe telekomunikacioni,bujqësisë,mbrojtjes mjedisore.

Planifikimi I territorit,shihet si një instrument shumë I vjefshëm me strategjinë e reduktimit të riskut për të ritur aftësinë ripërtëritëse të komuniteteve. Megjithatë duhet të rishikohet në krijimin e programeve për përmirësimin e strukturave nga risku sizmik.

9. MASAT DHE VEPRIMET PËR JETËSIMIN E STRATEGJISË.

9.1: INFORMIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE NGRITJA E KAPACITETEVE KOMUNITARE PËR ZVOGËLIMIN E RISKUT TË FATKEQËSIVE

9.1.1 Ngritja e Grupit të Vullnetarëve

Aktualisht në Bashkinë Përmet operojnë grupe të ndryshme vullnetarësh. Është e rëndësishme që grupet vullnetare të formalizohen. Duhet të ketë një listë të qartë të vullnetarëve,kapaciteteve të tyre dhe gatishmërisë për të marrë pjesë në raste emergjencash. Për këtë,bashkia duhet të krijojë një databazë të qartë e cila të ketë dhe pikat e kontaktit të anëtarëve.Listat e vullnetarëve duhet të plotësohen e përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, të paktën
1 herë në 6 muaj. Databaza e vullnetarëve duhet të menaxhohet nga Sektori i Emergjencave Civile pranë Bashkisë Përmet.

9.1.2 Trajnimi i Grupeve Vullnetare

Grupet vullnetare të konfirmuara duhet të trajnohen të paktën 1 herë në vit në lidhje me ndërhyrjet dhe menaxhimin e rasteve të ndryshme emergjencash. Trajnimet mund të përfshijnë simulime të rasteve të emergjencave. Ata duhet të njohin planin e Emergjencave Civile dhe **Strategjinë për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive** në Bashkinë Përmet. Grupet vullnetare duhet të kenë të qartë mënyrën e operimit, pikat e sigurta në Bashkinë Përmet etj. Trajnimi i grupeve vullnetare mund të kryhet në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile apo dhe organizata humanitare si Kryqi i Kuq.

9.1.3 Trajnimi i Komunitetit

Trajnimi i Komunitetit për të reaguar në raste të emergjencave është shumë i nevojshëm. Bashkia, duhet të krijojë një sërë trajnimesh, të shpërndara sipas njësive administrative dhe tipologjive të rrezikut. Këto trajnime duhet të jenë të vazhdueshme dhe të marrin në konsideratë grupe të ndryshme. Trajnimet mund të organizohen nga vetë Bashkia Përmet me strukturen e MZSH apo EC.
Trajnimet e komunitetit mund të përfshijnë edhe simulime të reagimit në raste të emergjencave, mënyra të evakuimit, apo të sjelljes në rast të ndonjë fatkeqësie.

9.1.4 Fushata Informimi Komuniteti

Bashkia Përmet duhet të zhvillojë aktivitete të ndryshme dhe të vazhdueshme për informimin e komunitetit në lidhje me risqet e fatkeqësive. Informimi mund të kryhet nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit si rrjete sociale, media audio-vizive, media të shkruara, takime me komunitetin etj. Përtej trajnimit të vazhdueshëm, informimi është një element thelbësor në lidhje me Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive. Të paktën dy herë në vit, bashkia duhet të zhvillojë fushata informimi. Këto mund të përfshijnë publikimin e broshurave si dhe mund të jenë të lidhura me ndryshimet stinore dhe rreziqet të lidhura me to. Fushatat e informimit duhet të lidhen dhe me veprime ose investime të kryera nga bashkia për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive. Informimi duhet të jetë transparent.

9.1.5 Fushata Ndërgjegjësimi për Pastrimin e Kanaleve Tretësore nga Fermerët

Një ndër faktorët i cili ka një ndikim të madh në **Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive** dhe ku komuniteti mund të luajë një rol të madh është pastrimi i kanaleve tretësore. Në këtë rast, bashkia duhet të zhvillojë fushata të ndryshme ndërgjegjësimi me fermerët për të garantuar që kanalet tretësore mirëmbahen dhe janë në gjendje funksionale. Bashkia mund të ofrojë dhe incentiva për pastrimin e kanaleve duke vendosur në përdorim pajisjet për pastrimin e kanaleve. Fushatat e ndërgjegjësimit mund të zhvillohen në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Gjithashtu,ato mund të shoqërohen dhe me kritere plotësuese për dhënien e fondeve mbështetëse për fermerët. Bashkia duhet të ketë të paktën 1 fushatë

ndërgjegjësimi në vit e cila duhet të përkojë me periudhën në të cilën kryhen punimet për mirëmbajtjen e kanaleve parësore e dytësore.

9.1.6 Fushata Ndërgjegjësimi për Rrezikun ndaj Zjarrit në Pyje

Zjarret në pyje zakonisht shkaktohen nga pakujdesia e komunitetit. Në këtë rast, bashkia mund të luajë një rol të rëndësishëm përsa i përket ndërgjegjësimit. Edhe në këtë rast, në periudhën Maj-Shtator, bashkia duhet të zhvillojë fushata të vazhdueshme ndërgjegjësimi. Këto fushata duhet të lidhen dhe me kontrolle të vazhdueshme. Fushatat e ndërgjegjësimit mund të kryhet duke përdorur kanale të ndryshme komunikimi qoftë këto nëpërmjet mediave qoftë me takime të drejtpërdrejta me komunitetin. Këto fushata ndërgjegjësimi mund të kryhen në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit, ADZM, MZSH me drejtoritë rajonale mjedisore si dhe me shërbimin pyjor.

9.1.7 Menaxhimi i Ekonomive Pyjore Nëpërmjet Komunitetit

Bashkia Përmet ka një kapacitet të reduktuar për menaxhimin e pyjeve. Kjo problematikë shpesh shoqërohet edhe me rritjen e zjarreve në pyje. Një nga mënyrat për të rregulluar këtë çështje është nëpërmjet perfshirjes se komunitetit në menaxhimin e tyre. Në këtë mënyrë, komuniteti merr një përgjegjësi më të madhe në reduktimin e riskut të zjarreve duke qënë se ka një interes të drejtpërdrejtë. Për këtë qëllim, është e rëndësishme që bashkia të hartoje Planet e Menaxhimit për të gjitha ekonomitë pyjore.

9.2: NGRITJA E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE, QEVERISËSE PËR ZVOGËLIMIN E RISKUT TË FATKEQËSIVE

9.2.1 Trajnim i Vazhduar Stafi i Bashkisë për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive

Stafi i bashkisë duhet të trajnohet dhe jetë i përditësuar me qasjen e **Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive**. Përtej sektorit të emergjencave civile, të gjithë sektorët e ndryshëm duhet të trajnohen të paktën 1 herë në vit në lidhje me integrimin e **Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive** në punën e tyre. Gjithashtu, kjo është shumë e rëndësishme për

të krijuar sinergji dhe për të garantuar që **Zvogëlimi i Riskut të Fatkeqësive** kthehet në politikë gjithëpërfshirëse në të gjithë sektorët. Trajnimet e stafit të bashkisë mund të zhvillohen në bashkëpunim me donatorë, me ASPA, apo dhe duke ngritur vetë kapacitetet e bashkisë. Pra staf kyç i bashkisë trajnohet e më pas kthehet në trajner për pjesën tjetër të stafit. Gjithashtu, inkurajohet dhe shkëmbimi I eksperiencave me vende të tjera. Një pjesë e stafit mund të shkojnë në vizita në institucione të tjera në rajon ose më gjerë për të marrë eksperitizë dhe eksperiencë.

9.2.2 Trajnim i Vazhduar i Komitetit të Mbrojtjes Civile

Komiteti i Mbrojtjes Civile është një hallkë shumë e rëndësishme për **Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive**. Komiteti duhet të përditësohet (me anëtarë të rinj, nëse është e nevojshme), dhe të mblidhet në mënyrë periodike.

Gjithashtu, Komiteti i Mbrojtjes Civile duhet të trajnohet në mënyrë të vazhdueshme. Të paktën 1 herë në vit, me tematika të ndryshme trajnimi në mënyrë që të jetë i përditësuar me qasjen e **Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive**. Trajnimi i Komitetit mund të kryhet me ekspertë të ndryshëm nga donatorë, me mbështetje të AKMC. Gjithashtu, anëtarë të ndryshëm të komitetit mund të kthehen në trajnues për çështje specifike sipas fushave të ekspertizës.

9.2.3 Rishikimi i PPV me Fokus Përshtatjen për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive

PPV-ja e Bashkisë Përmet duhet të rishikohet për të integruar në mënyrë të qënësishme faktorët e riskut. Është e rëndësishme që të rishikohen me vëmendje përcaktimet e planit për zhvillim në zona të cilat preken

nga fatkeqësi të ndryshme natyrore. Përcaktimet mund të ndryshohen në formën e përdorimeve të lejuara ose të kufizuara, kushtet e ndërtimit, si dhe rregulla shtesë për të zvogëluar riskun e fatkeqësive.

9.2.4 Rishikimi/ Hartimi i Strategjive dhe Planeve Sektoriale me Fokus Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive

Planet e ndryshme sektoriale duhet të rishikohen, ose të hartohen nga e para duke integruar qasjen e **Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive**. Planet/ Strategjitë për mbrojtjen mjedisore, trashëgiminë kulturore, zhvillimin ekonomik, turizmin, strehimin etj, duhet të rishikohen dhe ose hartohen duke marrë në konsiderate **Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive**. Kjo është e një ndër mënyrat kryesore për të future logjikën e **Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive** në të gjithë sektorët. Të gjitha planet, të cilat prekin territorin ose mund të ndihkojnë/ ndikohen nga fatkeqësitë, duhet të kalojnë për mendim tek Komisioni i Mbrojtjes Civile në Bashkinë Përmet në fazat e konsultimit dhe përpara miratimit.

9.2.5 Ngritja dhe Mirëmbajtja e Databazës së Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive *në Bashkinë Përmet*

Databaza e **Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive** në Bashkinë Përmet është një instrument thelbësor për monitorimin e fatkeqësive, zbatimin e strategjisë dhe **Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive**. Databaza duhet të menaxhohet nga sektori i emergjencave civile, dhe duhet të integrojë sektorë të ndryshëm. Databaza duhet të përditësohet, mirëmbahet dhe plotësohet me të dhëna të reja nga bashkia. Ajo duhet të përmbajë fatkeqësitë e ndodhura,dëmet e shkaktuara, parashikimet si dhe planet për ndërhyrje. Databaza i shërben bashkisë për përgatitjen e raportimeve të ndryshme, si dhe për të përmbushur detyrimet ligjore për rishikimin e strategjisë së **Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive** (çdo 5 vjet), përditësimin e vlerësimit (çdo tre vjet) dhe rishikimin e planit të emergjencave (çdo 3 vjet).

9.3: ZVOGËLIMI I RISKUT TË FATKEQËSIVE

9.3.1 Pastrimi i Kanaleve Dytësore

Bashkia Përmet ka në territorin e saj 49 km linear kanale dytësore, nga të cilat, vetëm 40% janë të mirëmbajtur dhe funksionalë, ndërkohë që pjesa tjetër janë pjesërisht ose totalisht të pamirëmbajtur. Kanalet dytësore janë kompetencë e bashkisë për mirëmbajtje, dhe ato duhet të pastrohen minimalisht 1herë në 2 vjet për të qënë funksionale. Në mënyrë që të arrijë të mbajë ritmin e ciklit të pastrimit, bashkia duhet të rrisë kapacitetet, me synim që I gjithë rrjeti I kanaleve të jetë I pastruar dhe funksional. Padyshim kjo mbetet një sfidë e madhe e bashkisë, por është ndër mënyrat më të rëndësishme për të zvogëluar riskun nga përmbytjet. Bashkia synon që këtë funksion ta kryejë me mjetet e veta, si rrjedhojë është e rëndëishme që të rriten kapacitetet me eskavatorë të fuqive të ndryshme.

9.3.2 Studim për Rehabilitimin dhe Ndërtimi i Pritave Malore

Vizitat në terren dhe intervistat me banorët tregojnë se përrenjt malorë janë një problematike e theksuar përsa i përket përmbytjeve. Ato, jo vetëm që përmbysin por edhe shkaktojnë dëme në infrastrukturë për shkak të vrullit të ujërave. Për këtë arsye, është e rëndësishme që të kryhet një studim i thelluar mbi llojin dhe nivelin e ndërhyrjes për prrenjtë malorë, veçanërisht në Njësinë Administrative Frashër dhe "Përroi I Bardhë" në qytet. Këto zonë kanë disa përrenjt malorë të rrëmbyeshëm ku infrastruktura ekzistuese si rrjedhojë e mosmirëmbajtjes është dëmtuar ose shkatërruar, ndërkohë, në raste të tjera mungon. Studimi, përtej gjendjes ekzistuese duhet të përmbajë dhe projektet teknike për
rehabilitimin dhe ndërtimin e pritave malore.

9.3.3 Rehabilitimi dhe Ndërtimi i Pritave Malore
Bazuar në studimin e mësipërm, bashkia duhet të kryejë ndërhyrjet për rehabilitimin dhe ndërtimin e pritave malore.

9.3.4 Studim mbi Gjendjen e Digave
Në bashkinë Përmet nuk është kryer asnjë studim në lidhje me digat dhe rezervuarët. Është shumë e rëndësishme që studimi të kryhet dhe të hartohen projektet teknike për rehabilitimin e tyre sipas nevojave. Digat, përtej rrezikut të
përmbytjeve janë një element thelbësor edhe për sigurinë dhe vënien në punë të rezervuarëve për ujitjen e tokave bujqësore. Duke marrë në konsideratë rrezikun e ndryshimeve klimatike dhe shtimin e thatësirave, bashkia duhet të synojë të vendosë sa më parë në punë me kapacitet të plotë rezervuarët. Përpara rivitalizimit të rezervuarëve është e rëndësishme që të garantohet siguria e digave.

9.3.5 Përmirësimi i Gjendjes së Digave sipas Studimit
Përmirësimi i gjendjes së digave duhet të kryhet bazuar në projektet e parashikuara në studimin përkatës.

9.3.6 Studim Sizmik për Ndërtesat me Moshë mbi 30 Vjet
Nisur nga eksperienca e tërmetit të Nëntor 2019, është e rëndëishme që bashkia të kryejë një vlerësim të thelluar dhe të detajuar të të gjitha ndërtesave. Kjo gjë do të lejonte një kuptueshmëri më të mirë të gjendjes në realitet dhe marrjen e masave për përforcimin e ndërtesave. Ndërtesat mbi 30 vjet, edhe pse mund të mos kenë pësuar dëme të konsiderueshme nga tërmeti i fundit,mund të jenë të rrezikuara për shkak të projektimit me kushte teknike të ndryshme nga ato të sotmet, materialeve dhe teknikave të ndërtimit të përdorura. Për këtë arsye është e rëndësishme
që të kryhet një studim i zgjatur në kohë për të identifikuar problematikat e të gjitha ndërtesave të zhvilluara përpara viteve 1990.

9.3.7 Studim Sizmik për Ndërtesat me Rëndësi të Veçantë
Bashkia duhet të ndërmarrë studime të detajuara të ndërtesave me rëndësi të veçantë. Këto ndërtesa mund të cilësohen shkolla, kopshte, çerdhe, spitali, qëndra shëndetësore, biblioteka,ndërtesa të trashëgimisë historike e kulturore si dhe në tërësi ndërtesa të cilat janë publike dhe lejojnë për një grumbullim të madh njerëzish.

9.3.8 Studim Sizmik për Ndërtesat Informale
Ndërtesat informale, duke qënë se janë ndërtuar pa ndonjë studim të saktë, shpesh në toka me formacione të dobëta, në analogji me ndërtesat të cilat kanë një moshë mbi 30 vjet, është e nevojshme që të kalojnë një verifikim të detajuar në lidhje me cilësinë e ndërtimit dhe përballimit të ngjarjeve të mundshme sizmike në të ardhmen. Këto studime mund të kryhen në bashkëpunim me ALUIZNIN si pjesë e procedurave të legalizimit.

9.3.9 Marrja e Masave për Përmirësimin e Kushteve të Ndërtesave
Pas kryerjes së studimeve të mësipërme është e rëndësishme që të merren masat e nevojshme inxhinierike për përmirësimin e kushteve inxhinieriko-sizmike të tyre. Prioritet në këtë rast duhet të kenë ndërtesat për qëllime publike dhe që akomodojnë grupe të mëdha qytetarësh. Gjithashtu, bashkia duhet të punojë ngushtë me komunitetin për tëfacilituar procesin e ndërgjegjësuar komunitetin për masat që duhen ndërmarrë. Në raste të grupeve në nevojë, ku mund të identifikohen banesa problematike, bashkia mund të shfrytëzojë programet e strehimit social për të përmirësuar gjendjen e tyre.

9.3.10 Studim dhe Monitorim i Zonave me Rrezik Rrëshqitje

Bashkia Përmet ka disa zona të rrezikshme për rrëshqitje toke dhe gurësh. Këto zona mund të aktivizohen nga ndërhyrje njerëzore dhe/ose nga rënia e rreshjeve me intensitet të lartë për një kohë të gjatë. Duke marrë në konsideratë tipologjinë e impakteve të ndryshimeve klimatike, ku ndryshimi i regjimit të rreshjeve, me rreshje më intensive dhe në një hark kohor më të shkurtër, mund të krijohen kushtet në të ardhmen për të aktivizuar rrëshqitjen e tokave. Për këtë qëllim, sugjerohet vendosja dhe monitorimi i 3 zonave (kurora e qytetit; fshati Gjinkar; fshati Zhepë) merrëshqitje, në mënyrë që më pas të merren masa të përshtatshme inxhinierike .

9.3.11 Studim mbi Largimin e Shkëmbinjve/Gurrëve me Rrezik

Janë identifikuar tre zona ku shkëmbinjtë bien nga shpatet dhe rrezikojnë rrugët dhe ndërtesat që janë në fund të shpatit. Zonat më të rëndësishme ku është i pranishëm ky fenomen janë: kurora e qytetit, fshati Gjinkar dhe fshati Zhepë për disa vite ka një rënie gurësh në drejtim të shtëpive dhe në rrugë. Pjerrësia është e mbuluar me bimësi,

por një pjesë është pa bimësi, e ndërtuar me shkëmbinj gëlqeror. Nga vëzhgimet sipërfaqësore kemi konstatuar se në shpat ka shumë gurë me dimensione të mëdha 1-2m^3 të cilat janë gati të bien. Ky është një fenomen i rrezikshëm që kërcënon jetën e njerëzve që jetojnë atje. Rekomandojmë që të bëhet një studim i detajuar gjeologjik për këtë zonë dhe bazuar në të dhënat e marra nga ky studim, të merren masa inxhinierike për të parandaluar rënien e gurëve

9.3.12 Marrja e Masave për Largimin e Shkëmbinjve/ Gurrëve

Pas hartimit të studimit, bashkia Përmet duhet të fillojë menjëherë që të ndërmarrë masa për largimin e shkëmbinjve/gurrëve. Ndërhyrjet duhet të prioritarizohen sipas nivelit të rrezikut në jetën e banorëve. Ndërhyrjet mund të përfshijnë shpërthime të kontrolluara, mbajtje me masa inxhinierike, si dhe vendosjen e rrjetave ku është e pamundur që të përdoren masat e tjera. Disa ndërhyrje mund të kryhen në bashkëpunim me institucionet kombëtare si Ministria e Mbrojtjes (shpërthime të kontrolluara), ARRSH (akse rrugore Nacionale) apo dhe donatorë.

9.3.13 Pyllëzimi i Zonave Pyjore të Djegura

Çdo vit, bashkia Përmet ka në territorin e saj sipërfaqe pyjesh të djegura. Në këtë rast, është e nevojshme, që çdo vit, bashkia të ndjekë fushata të vazhdueshme pyllëzimi në mënyrë që të bëjë zëvendësimin e fondit pyjor të djegur. Këshillohet që pyllëzimet të kryhen me pemë autoktone të cilat përshtaten shumë më mirë me kushtet atmosferike, terrenin dhe bimësinë përreth tyre.

9.3.14 Studim Inxhinierik për Gjendjen e Infrastrukturave Kritike (ura dhe pacarela)

Bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe të riskut, janë evidentuar një sërë urash të cilat kanë problem inxhinierike dhe mund të dëmtohen më tej në rast të fatkeqësive natyrore. Urat dhe pacarelat janë infrastrukture kritike pasi shkatërrimi i tyre mund të bllokojë lëvizjen e popullatës në rast evakuimi. Për këtë qëllim, është e rëndësishme që bashkia Përmet të bëjë një inspektim të thelluar të të gjitha urave dhe pacarelave të identifikuara si problematike.

9.3.15 Marrja e Masave Inxhinierike për Përmirësimin e Gjendjes së Infrastrukturave Kritike (ura dhe pacarela)

Bashkia Përmet, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse në nivel kombëtar, pas hartimit të studimeve në lidhje me gjendjen e infrastrukturave kritike, duhet të ndërmarrë menjëherë ndërhyrjet përkatëse. Përsa u përket pacarelave mbi lumin Vjosë ndërhyrjet mund të kryhen dhe pa patur ndonjë studim të veçantë.

9.4: NGRITJA E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE, OPERACIONALE DHE PËRGATITJA PËR PËRBALLJEN E SITUATAVE EMERGJENTE

9.4.1 Hartimi, Monitorimi dhe Përditësimi i Planit të Emergjencave Civile

Bashkia Përmet që prej vitit 2020 ka një plan të Emergjencave Civile. Ky plan, duhet të monitorohet dhe të përditësohet bazuar në parashikimet ligjore. Detyra për monitorimin dhe përditësimin e planit të emergjencave është e Sektorit të Emergjencave Civile në bashki.

9.4.2 Hartimi i Planeve të Evakuimit në Ndërtesa të Rëndësisë së Veçantë dhe Vendosja e Sinjalistikës së Nevojshme

Në të gjitha ndërtesat publike duhet të hartohen dhe të vendosen planet e evakuimit dhe të pajisen me sinjalistikën e nevojshme. Në shumë raste, në shkolla apo institucione publike ekzistojnë planet e evakuimit por nuk ka sinjalistikën e duhur për të orientuar evakuimin e njerëzve.

9.4.3 Plotësimi i Nevojave me Pajisje për Rastet e Emergjencave

Bazuar në parashikimet e Planit të Emergjencave Civile duhet të bëhet plotësimi me pajisje për rastet e emergjencave.

9.4.4 Ngritja e Sistemeve të Paralajmërimit të Hershëm

Bashkia Përmet aktualisht nuk ka një sistem të formalizuar të paralajmërimit të hershëm në rast të fatkeqësive natyrore. Ky sistem mungon fizikisht, në formën e alarmeve të vendosura në pika të ndryshme të bashkisë, ashtu si dhe elektronikisht. Duke marrë në konsideratë avancimin e teknologjisë dhe koston e ngritjes së sistemeve të tilla të alarmit, mundësia më e mirë është duke përdorur aplikacione të cilat instalohen dhe shpërndahen nëpërmjet telefonave. Këto lloj sistemesh janë të lehta për tu përdorur, ndihmojnë në shpërndarjen e informacionit në kohë reale, dhe në krijimin e databazave për rreziqet. Sfida në këtë rast, është mirambajtja nga ana e bashkisë. Pas ndërtimit të arkitekturës së sistemit dhe aplikacionin, bashkia duhet të krijojë një databazë dhe duhet të mirëmbajë në mënyrë të herëpasherëshme aplikacionin.

10:VLERËSIME PËRFUNDIMTARE

Bazuar në historikun e të dhënave për fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, Bashkia Përmet përballet me një shumëllojshmëri rreziqesh e për pasojë edhe risqesh të fatkeqësive natyrore. Përmeti është i rrezikuar nga zjarret në pyje e kullota, nga bllokimi i rrugëve nga dëbora, ndryshimi i regjimit të reshjeve , ndryshimet klimatike të manifesuara me rritje propabilitetin e shtimit të fatkeqësive në të ardhmen të përmbytjeve si dhe rreziku nga objektet me burim rreziku (objekte te vjetra, ura dhe pacarela etj). Tërmetet e vitit 2019 edhe pse nuk sollen humbje të jetëve njerëzore dhe dëme material në në territorin e bashkisë Përmet, rrisjell në vëmendje një risk të përhershëm. Risqet e tjera që vijnë nga zjarret në pyje e kullota,bllokimi nga dëbora, gëryerja e tokës, rënia e gurëve dhe shkëmbenjve, përmbytjet pavarësisht nga dëmi janë prezent në territorin e bashkisë Përmet.

Në shkallë bashkie ka kapacitete për përgjigje ndaj fatkeqësive duke përfshirë shërbimet e përditshme të emergjencave, si shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, forcat e policisë së shtetit, shërbimi i urgjencës shëndetësore dhe strukturat e tjera të shërbimit shëndetësor, spitalet, njësia vendore e shëndetit publik, institucione publike, subjekte private dhe organizata jofitimprurëse.

Në emergjencat që tejkalojnë kapacitetet e shërbimeve të emergjencave civile të bashkisë Përmet për të përballuar situatën e krijuar nga fatkeqësia mund të angazhohen dhe kapacitete shtesë nga njësitë e vetëqeverisjes të bashkive të tjera të Prefekturës Gjirokaster apo dhe bashkive fqinje te qaeqeve te tjera. Duke u mbështetur në parimin e subsidiaritetit kur kapacitetet janë të pamjaftueshme për të përballuar situatën e krijuar nga fatkeqësitë, kërkohet angazhimi i kapaciteteve të tjera shtetërore, duke përfshirë Forcat

e Armatosura, Policinë e Shtetit, etj.
Mbi bazën e ligjit të Mbrojtjes Civile në Ministrinë e Mbrojtjes është ngritur dhe funksionon Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, si person juridik publik qëndror me autoritet koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës, kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civle. Është ngritur dhe funksionon Qëndra Operacionale që punon 24 orë në 7 ditë.
Në Prefekturë është Sektori I Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile, ku Prefekti ka rolin parësor në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në nivel qarku.
Në bashki është ngritur dhe funksionon sektori I emergjencave civile ,I cili ka rol informues dhe koordinues në fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

11: REFERENCA LIGJORE

Ligj Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar
Ligj Nr. 45/2019 "Për mbrojtjen Civile"
Ligj Nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut"
Ligj Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar
Ligj Nr. 91/2013, dt 28/02/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor"
Ligj Nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar
Ligj nr. 57/2020 "Për pyjet"
Ligj Nr. 9244, dt. 17/06/2004, "Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore", i ndryshuar
Ligj Nr.24/2017 "Për Administrimin e Ujitjes dhe Kullimit"
Ligj Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".
VKM Nr. 686, 22.11.2017, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar
VKM Nr. 408, dt 13/05/2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar
VKM Nr. 431, datë 11.7.2018 Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve"
Akti Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore"
i miratuar me Ligjin nr. 97/2019 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore"

12: DOKUMENTE STRATEGJIKE

Plani i Emergjencave Civile Bashkia Përmet.

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Përmet.

Evidentimi i rreziqeve natyrore në Shqipëri. IGJIU(2017).

Florand Hasani

Bekim Meçani

Laert Bushi

Arjan Jaupi

Bujar Ibrahimi

Thanas Nikolla

Fredi Lipe